



RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS

STANDARDET PROFESIONALE DHE
PARIMET ETIKE TË GAZETARISË NË
PROGRAMET E RADIOTELEVIZIONIT
TË KOSOVËS

PARATHËNIE

Mediat luajnë një rol të rëndësishëm në shoqëri dhe televizioni është pa dyshim mediumi me më shumë ndikim; nëpërmes emetimit të informatave, këndvështrimeve dhe mendimeve, me anë të fotografisë dhe zërit, ajo arrin tek një auditor i gjerë.

Prandaj, vendosja e rregullave të lojës dhe përcaktimi i dimensioneve dhe implikimeve të së drejtës për informim dhe të lirisë së fjalës së lirë është detyrë e domosdoshme. Ne synojmë të vendosim një ekuilibër ku një liri nuk e përjashton tjetrën. Me rastin e zgjerimit të kufijve të lirisë duhet pasur parasysh lirinë e çdo individit. Për këtë nuk mjafton vetëm përvoja, por kërkohet gjithashtu edhe një guxim i madh.

Përcaktimi i këtyre rregullave nuk është detyrë që duhet t'i lihet Parlamentit, pasi këto janë më tepër standarde etike në krijimin e programit sesa rregulla ligjore. Etika e mediumit publik i ka rrënjët në njohuritë profesionale dhe vetërregullimin e shëndoshë të formësuar nga këto njohuri.

*Bordi i Drejtorëve i RTK-së në seancën e mbajtur me 25 janar 2005 ka miratuar **Standardet Profesionale** me bindje të plotë se përhapja e informatave dhe shprehja e fjalës së lirë nuk mund të ndalohen më, ngaqë Evropa e mileniumit të ri nuk pranon asnjë formë të censurës dhe të vetëcensurës. Ne i kemi mishëruar këto standarde nga bindja se etika, profesionalizmi, drejtësia dhe objektiviteti duhet të jenë parime udhëheqëse për një transmetues publik. Parimet etike të miratuara këtu janë të hapura për amandamente, plotësime dhe përmirësime gjatë punës dhe praktikës së ardhshme. Besojmë se këto parime do ta udhëheqin RTK-në në një epokë të re të gazetarisë së paanshme dhe të balancuar.*

*Vjosa Dobruna
Kryetare e Bordit të Drejtorëve të RTK-së*

PËRMBAJTJA

1 STANDARDET PROFESIONALE

- 1.1 Saktësia
- 1.2 Paanshmëria
- 1.3 Verifikimi i fakteve
- 1.4 Besueshmëria
- 1.5 Përgjegjësia
- 1.6 Mundësia e publikut për qasje në punë
- 1.7 Pavarësia
- 1.8 Drejtësia
- 1.9 Gjuha

2 SHUMËLLOJSHMËRIA DHE EKUILIBRI NË RAPORTIM

- 2.1 Spektri i temave
- 2.2 Spektri i mendimeve
- 2.3 Ekuilibrimi i informatave
 - 1.3.1 Ekuilibrimi i informatave në një program të vetëm
 - 2.3.2 Ekuilibrimi i informatave në një seri të programeve
 - 2.3.3 Ekuilibrimi i informatave në lajme dhe programe që trajtojnë probleme aktuale
 - 2.3.4 Ekuilibrimi i informatave në dokumentarët dramatikë

3 FUSHATAT ZGJEDHORE

- 3.1 Referim për parlamentin dhe politikanët
- 3.2 Ballafaqimi i partive politike dhe kandidatëve
- 3.3 Ekuilibrimi i raporteve mbi fushatat zgjedhore në emetime të tjera
- 3.4 Sondazhet e pjesëmarrësve në votime
- 3.5 Raportimi i rezultateve të zgjedhjeve

4 MBULIMI I ÇËSHTJEVE POLITIKE, I PARLAMENTIT DHE POLITIKANËVE

- 4.1 Programet që trajtojnë materiale mbi parlamentin dhe transmetimi i seancave parlamentare
- 4.2 Mbulimi i partive politike
- 4.3 Terminologjia politike

5 PARAQITJA E STANDARDEVE

- 5.1 Mbledhja e informatave
 - 5.1.1 Sondazhet e opinionit

- 5.1.2 Metodatat e realizimit të sondazheve të opinionit
- 5.1.3 Emetimi i rezultateve të sondazheve të opinionit
- 5.1.4 Anketat joshkencore
- 5.1.5 Votimi përmes telefonit
- 5.2 Intimiteti dhe mbledhja e informatave
 - 5.2.1 Intimiteti kundruall jetës publike
 - 5.2.2 Identiteti i një të dyshimti
 - 5.2.3 Identiteti i një të akuzuari
 - 5.2.4 Identiteti i viktimës së krimit
- 5.3 Mbrojtja e burimeve të informimit
 - 5.3.1 Pjesëmarrësit anonimë në program
 - 5.3.2 Refuzimi për t'u paraqitur në program
 - 5.3.3 Embargot
- 5.4 Lajmet
- 5.5 Raportet
- 5.6 Intervistimet
 - 5.6.1 Intervistimet përmes telefonit
- 5.7 Komentet
- 5.8 Pagesat
 - 5.8.1 PAGESA E BURIMEVE TË LAJMEVE
 - 5.8.2 PAGESA E HONORAREVE
 - 5.8.3 Pagesat e parlamentarëve, këshilltarëve shtetërorë, ministrave zyrtarëve politikë dhe atyre të qeverisë
- 5.9 Mbulimi i ngjarjeve të veçanta
 - 5.9.1 Mbulimi i demonstratave
 - 5.9.2 Trazirat qytetare
 - 5.9.3 Terrorizmi
- 5.10 Raportimi i krimeve dhe aksidenteve
 - 5.10.1 Mjetet profesionale
 - 5.10.1.1 Teksti
 - 5.10.1.2 Fotografia

6 RAPORTET ME AUTORITET SHTETËRORE/ ORGANET QEVERITARE

- 6.1 Raportet me armatën
- 6.2 Raportet me policinë

7 SJELLJET IMITUESE DHE JOSOCIALE

- 7.1 Metodatat klandestine të mbledhjes së lajmeve
- 7.2 Shtrembërimi i lajmeve
- 7.3 Kamerat dhe mikrofonët e fshehur
- 7.4 Rrjedhja e informatave zyrtare secrete

8 GAZETARIA HULUMTUESE

9 PËRPUNIMI I INFORMATAVE

- 9.1 Nikoqirët dhe intervistuesit
- 9.2 Reporterët
- 9.3 Komentatorët mysafirë
- 9.4 Redaktimi
- 9.5 Redaktimi i intervistave
- 9.6 Shfrytëzimi i materialeve arkivore
- 9.7 Shfrytëzimi i teknologjisë në redaktim
- 9.8 Krijimi i fotografive
 - 9.8.1 Incizimi, zgjedhja e formave dhe këndeve
 - 9.8.1.1 Këndi i poshtëm i kamerës
 - 9.8.1.2 Afrimi dhe largimi
 - 9.8.1.3 Këndet e kamerës dhe teknikat
 - 9.8.2 Redaktimi
 - 9.8.3 Shfrytëzimi i teknologjisë kompjuterike
- 9.9 Rikonstruktimi dhe simulimi i një ngjarjeje
- 9.10 Materiali arkivor
 - 9.10.1 Etiketimi i materialit arkivor
 - 9.10.2 Keqpërdorimi i materialit arkivor
- 9.11 Materiali arkivor që paraqet krimin
- 9.12 Përzjerja e aktualitetit dhe dramatizimit
- 9.13 Satira

10 RESPEKTIMI I VLERAVE TË SHIKUESVE DHE DËGJUESVE

- 10.1 Shija e mirë
- 10.2 Raportimi për çështjet shëndetësore
- 10.3 Seksi
- 10.4 Pikëllimi dhe vuajtja
- 10.5 Dhuna
- 10.6 Njoftimet paralajmëruese
- 10.7 Ndërprerja e programit
- 10.8 Veçoritë e radios

11 PROGRAMET ME INTERES TË VEÇANTË

- 11.1 Programet për pakicat kombëtare
- 11.2 Kosovarët që jetojnë jashtë shtetit
- 11.3 Programet religjioze
- 11.4 Paraqitja e religjionit dhe grupeve religjioze
- 11.5 Shërbimet ndërkombëtare

12 PARAQITJA E GRUPEVE TË POSAÇME TË SHOQËRISË

- 12.1 Paraqitja e femrave
- 12.2 Paraqitja e njerëzve me aftësi të kufizuara
- 12.3 Paraqitja e pakicave seksuale
- 12.4 Paraqitja e njerëzve të moshuar

13 FËMIJËT DHE TË MITURIT NË PROGRAMET E RTK-së

14 NDËRHJRJA

- 14.1 Kërkesat drejtuar RTK-së për të ndaluar materialin
- 14.2 Vetoja e programit nga pjesëmarrësi në program
- 14.3 Censura

15. E DREJTA PËR KORRIGJIM

16. OMBUDSMANI /MBROJTËS I STANDARDEVE PROFESIONALE DHE PARIMEVE TË ETIKËS GAZETARESKE

17. REFERIMI I DOMOSDOSHËM

18. NDIHMA LIGJORE PËR GAZETARËT DHE REDAKTORËT

19. REKLAMIMI , PROMOVIMI DHE SPONSORIMI NË PROGRAMET E RTK-SË

- 19.1 Kriteret etike të reklamimit
- 19.2 Reklamimi dhe promovimi
- 19.3 Reklamimi për qëllime humanitare
- 19.4 Emetimi i materialeve mbi marrëdhëniet shoqërore
- 19.5 Gazetarët, prezentuesit dhe redaktorët që shfaqen në reklamime dhe programe promovuese
- 19.6 Sponsorimi i programeve

20. PARAQITJA NË EMISION DHE KODET E VESHJES

21. KONFLIKTI I INTERESAVE, TË DREJTAT DHE DETYRIMET

- 21.1 Konflikti i biznesit dhe interesave financiare
- 21.2 Paraqitja dhe pjesëmarrja në mediat rivale elektronike
- 21.3 Aktiviteti ekonomik
- 21.4 Gazetaria financiare
- 21.5 Dhuratat, përfitimet dhe interesat e tjera të veçanta
- 21.6 Aktivitetet profesionale, politike dhe sindikaliste

22. DISPOZITAT PËRMBYLLËSE

1 STANDARDET PROFESIONALE

Programet e bazuara në fakte/lajme, si dhe të gjitha programet e tjera të RTK-së, përfshirë edhe raportimin duhet të mbështeten në standardet profesionale të cekura më poshtë:

1.1 Saktësia

Lajmi i transmetuar duhet të pasqyrojë faktet dhe nuk mund të jetë lajm mashtrues apo i pavërtetë. Gazetari është i obliguar t'i mbledh informacionet me shumë kujdes, t'i verifikojë ato dhe t'u kushtojë kujdesin përkatës për t'i prezentuar në variantin letrar të gjuhës shqipe apo të gjuhës së minoriteteve vendore. Raportimi për problemet aktuale, që prezenton persona të vërtetë, duhet t'u shmanget teknikave të realitetit virtual, përpos në rastet kur kjo është në dobi të lajmit dhe të mbrojtjes së të drejtave personale.

1.2 Paanshmëria

Paanshmëria është vlerë themelore e të gjitha programeve të RTK-së, i cili duke qenë transmetues publik, ka për mision informimin objektiv të publikut. Lajmet e emetuara për auditorin, nuk bën të jenë të pavërteta.

Raportimi duhet të jetë i qetë, i gjerë dhe mirë i informuar. Faktet dhe pikëpamjet duhet të transmetohen dhe prezentohen në mënyrë të balancuar dhe raportimi duhet të marrë parasysh të gjithë personat, institucionet, çështjet dhe ndodhitë, në mënyrë të paanshme dhe etike.

Paanshmëria në programet e bazuara në fakte nuk mund të sigurohet me një balancim të thjeshtë matematikor, që peshon pikëpamjet e

njërit ndaj pikëpamjeve të kundërta të tjetrit, por me anë të një prezentimi të plotë të rrethanave, që u japin përparësi këtyre pikëpamjeve.

Raportimi duhet t'i shmanget çdo gjëje që do të shkaktonte dyshim të arsyeshëm lidhur me paanshmërinë e gazetarit apo të transmetuesit publik, apo ndaj raportimit që do të mund të krijonte idenë se gazetari apo transmetuesi janë nën ndikimin e ndonjë grupi të caktuar, qoftë ai i natyrës ideologjike, politike, financiare, sociale, religjioze apo kulturore.

Kërkesa për paanshmëri nuk mund të barazohet gjithmonë me netutralitet të plotë për secilën pjesë të lajmit. Raportuesi duhet të shprehë vlerësimin profesional dhe gazetaresk bazuar në fakte përkatëse, por jo edhe mendimin personal të krijuar si rrjedhojë e pikëpamjeve të njëanshme në çështje të caktuara.

Prodhuesit e programeve të ndryshme radiotelevizive (të punësuarit dhe mysafirët) nuk mund të fshehin apo të mos përfillin informacionin, me të cilin ata nuk pajtohen personalisht.

1.3 Verifikimi i fakteve

Gazetarët dhe redaktorët e RTK-së duhet të respektojnë rregullën themelore profesionale, sipas së cilës të gjitha faktet duhet të verifikohen para se të emetohen. Nëse verifikimi nuk është i mundur, burimi duhet të ceket. Nëse burimi është i njohur dhe i besueshëm për redaktorët por ata nuk duan ta zbulojnë burimin, atëherë mund të përdoren fraza të caktuara përshkruese, siç janë: "nga burime të besueshme", "prej burimeve të verifikuara", "nga burime të mirë-informuara", "nga burime diplomatike", "nga burime të afërta me...", etj. Programet e RTK-së, si rregull, i shmangen përdorimit të frazave të tilla si: "është thënë", "fjala është për", "kemi dëgjuar", etj.

Vëmendje e veçantë kërkohet me rastin e përdorimit të burimeve të paautorizuara nga Interneti, pasi që ky rrjet mbarëbotëror mundëson qasje të pakufizuar dhe jokritike të shfrytëzimit të të dhënave nga këto burime dhe mund të shpie në dhënien e informacionit të gabuar. Para emetimit të materialit të paautorizuar nga Interneti, duhet të verifikohen të gjitha faktet. Nëse është shfrytëzuar një burim i paautorizuar nga Interneti, kjo duhet të tregohet qartë.

1.4 Besueshmëria

Në shoqërinë demokratike besueshmëria është një nga vlerat themelore të transmetimit publik.

Gazetarët dhe të gjithë prodhuesit e tjerë të programeve të RTK-së, duhet të jenë të pavarur në punën e tyre dhe duhet të ruajnë autonominë e profesionit të gazetarit dhe të të gjitha profesioneve të

tjera që ndihmojnë në krijimin e imazhit të programeve të radios dhe të televizionit.

Programet e lajmeve duhet të ofrojnë shpjegime përkatëse të ngjarjeve dhe çështjeve që i mundësojnë auditorit të radios dhe televizionit të krijojnë përshtypjet e veta.

Besueshmëria kërkon që secili që i kontribuon programeve të RTK-së, t'i shmanget shprehjes së përkrahjes publike të çfarëdo veprimi të ndërmarrë nga partitë politike apo nga shoqatat, grupet shoqërore dhe grupet lobiste. Menaxhmenti poashtu, në parim nuk do të lejoj që marrëdhëniet familjare të stafit të RTK -së të ndikojnë në programet e RTK-së (marrëdhëniet grua - burrë, vëllë - motër, prind - fëmijë, etj). Nëse është domosdoshme redaktorët e RTK-së do të ndërmarrin masat e nevojshme që të parandalojnë paraqitjen e familjarizmit apo raportimit të njohësve politik, të bazuar në lidhjet familjare, sidomos në emisionet informative.

1.5 Përgjegjësia

Qëllimi kryesor i mbledhjes dhe emetimit të lajmeve është që të sigurojë një qasje sa më të gjerë të mundshme dhe t'u mundësojë shfrytëzuesve të krijojnë një opinion për një çështje të caktuar. Gazetarët dhe redaktorët që keqpërdorin pozitën e tyre për të përhapur lajme të rrejshme apo të kurdisura duhet të ndalohen.

Përgjegjësia gjithashtu përfshin edhe ndjeshmërinë dhe mbajtjen e një distance të caktuar ndaj materialeve që përhapen nga agjencitë dhe mediat private, të cilat, për qëllime përfitimi financiar, mund të krijojnë imazh dhe reputacion për personalitete të veçanta, pavarësisht nga faktet.

Programet e RTK-së përmbajnë raportime mbi të gjitha ngjarjet tek ne dhe në botë, që janë me rëndësi për publikun. Të njëjtat standarde dhe parime etike vlejné edhe gjatë raportimit mbi ngjarjet që ndodhin brenda RTK-së.

1.6 Qasja e publikut në punën e gazetarëve

Puna gazetareske është publike dhe gazetarët e RTK-së duhet të punojnë në përputhje me këtë rregull dhe të refuzojnë në mënyrë kategorike çdo përpjekje nga çdo institucion apo individ që të kufizojë qasjen e publikut në punën gazetareske, apo përpjekjet për ta shfrytëzuar atë për interesa të caktuara, që nuk janë në përputhje me parimet e lirisë dhe të pavarësisë së profesionit të gazetarit. Ruajtja e fshehtësisë së burimeve, që rekomandohet nga Këshilli i Evropës, duhet të respektohet, me përjashtim të rasteve, kur rrezikohet jeta dhe siguria e individëve (rastet e paralajmërimit për vendosjen e bombave apo shpërthimi i zjarrit, kidnapimi apo kërcënimet e ngjashme, por jo edhe rastet e bazuara në ndjenjat subjektive të ndonjë individi, apo kur ajo përdoret si një arsyetim për të shmangur

gazetarët), apo në rastet kur redaktorët dhe gazetarët duke mos pbulikuar burimet e informacionit do të fshihnin aktet kriminale të individëve, grupeve dhe organizatave.

1.7 Pavarësia

Gazetarët, në punën e tyre, duhet domosdoshmërisht të mbështeteten në parimet e autonomisë dhe të pavarësisë së programeve të RTK-së, bazuar në politikën programore të përcaktuar nga Bordi i Drejtorëve të RTK-së. Ata në asnjë rast nuk duhet të krijojnë përshtypjet e tyre në bazë të paragjyimit apo të lejojnë shtrembërimin e integritetit të tyre profesional.

Madje, edhe në rastet kur prodhimi i programeve të RTK-së mbështetet nga investitorë të pavarur (buxheti i shtetit, sponsorët, etj.), RTK-ja duhet të vazhdojë politikën e vet të pavarur redaktuese gjatë përgatitjes së këtyre programeve. Programet gjithashtu u nënshtrohen standardeve profesionale dhe etikes, siç janë paraqitur në këtë dokument.

1.8 Drejtësia

Gazetarët dhe redaktorët e RTK-së, gjatë raportimit duhet të respektojnë integritetin personal të individëve dhe të drejtat e tyre për intimitet. Personave që sulmohen dhe kritikohen ashpër në programet e RTK-së, duhet dhënë rasti për t'iu përgjigjur sa më shpejt që është e mundur. Kundërpërgjigjja duhet të emetohet në të njëjtin emision dhe në të njëjtin termin kohor kur është bërë kritika; koha e dedikuar për të kritikuarin për t'iu kundërvënë kritikave duhet të jetë e njëjtë me kohëzgjatjen e kritikës së mëparshme. Kundërpërgjigjet që i tejkalojnë këto rregulla mund të refuzohen nga kryeredaktori i programit.

Asnjë lajm apo përmbajtje programore nuk konsiderohet e drejtë, nëse:

- a) nuk i përmban të gjitha faktet e rëndësishme,
- b) përmban fakte të parëndësishme dhe i shpërfill ato më të rëndësishmet,
- c) padashur apo me qëllim mashtron shikuesit dhe dëgjuesit,
- d) raportuesit përdorin shprehje ose makinacione që zbulojnë njëanshmërinë e tyre.

1.9 Gjuha

RTK-ja, si transmetues publik, duhet t'i kushtojë kujdes të veçantë gjuhës.

Gjuha duhet të jetë e qartë dhe e thjeshtë, duhet të shmang

zmadhimet dhe dykuptimësinë. Prezentuesit dhe moderatorët e programit, si dhe gazetarët, (përfshirë këtu të gjithë të punësuarit e tjerë dhe punëtorët e pavarur që punojnë në sajimin e programit) janë të obliguar të përdorin gjuhën letrare shqipe, apo gjuhët e komuniteteve etnike vendore (serbe, boshnjake, turke dhe rome); spikerët profesionistë dhe gazetarët duhet të përdorin gjuhën standarde gjatë leximit, si dhe gjatë moderimit të përdorin gjuhën e përditshme standarde. Përdorimi i dialekteve është i pranueshëm vetëm kur përdoret nga persona që nuk janë punëtorë të RTK-së, ose në rastet me interes social të veçantë (siç është p.sh ruajtja e dialekteve të caktuara).

Parimisht, në programet e RTK-së nuk lejohet përdorimi i shprehjeve vulgare apo përdorimi i gjuhës që nuk është në përputhje me normat e mirëqenies sociale. Sidoqoftë, duhet të jemi të vetëdijshëm se pranueshmëria e shprehjeve të caktuara dhe gjuhës nga ana e publikut po ndryshon në mënyrë të vazhdueshme dhe ka lëvizur me kohën.

Në rrethana të caktuara, disa shprehje gjuhësore janë të pranueshme, edhe pse në rrethana të tjera, ato mund të shkaktojnë pakënaqësi. Megjithatë, ato duhet t'i kontribuojnë mesazhit që përcjell programi. Për më tepër, duhet të aresyetohet se shmangia e këtyre shprehjeve do të mund të ndikonte negativisht në plotësinë e programit.

2 SHUMËLLOJSHMËRIA DHE BALANCIMI I RAPORTIT

2.1 Spektri i temave

Programet e RTK-së duhet të sigurojnë një ekuilibrim të duhur midis lajmeve ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe atyre lokale.

Është poaq me rëndësi që gazetarët dhe prodhuesit e tjerë të programeve të RTK-së të hulumtojnë dhe të prezantojnë, si ngjarje pozitive ashtu edhe ato negative, personalitete dhe fenomene sociale, në veçanti ngjarje dhe fenomene "madhore", edhe pse ato mund të mos tërheqin vëmendjen dhe të mos jenë shumë tërheqëse për publikun.

2.2 Spektri i mendimeve

Me qëllim të arritjes së balancimit dhe paanshmërisë, RTK-ja duhet të sigurojë paraqitjen e një spektri sa më të gjerë të mundshëm të pikëpamjeve dhe mendimeve të ndryshme. Emisionet e RTK-së duhet të jenë politikisht neutrale, që do të thotë se gazetarëve dhe redaktorëve nuk u lejohet të paraqesin preferenca personale për ndonjë pikëpamje politike apo ideologjike. Prezentimi i pikëpamjeve dhe mendimeve duhet të jetë i plotë, duke përfshirë të gjitha

dimensionet dhe shkallët. Emisionet e RTK-së duhet të jenë të plota. Nëse kjo nuk mund të arrihet me një lajm të vetëm, ajo duhet të realizohet përmes një serie që i dedikohet një çështjeje të caktuar. Nëse për arsye të caktuara, një lajm nuk është i balancuar, ai duhet të emërtohet qartë si i tillë, dhe auditori duhet të informohet për datën dhe kohën e saktë të emetimit të vazhdimin të programit, ku do të përfshihen edhe faktet që kanë munguar në emisionin e parë. Pjesët e lajmeve dhe të programeve që trajtojnë çështje aktuale duhet të ndiqen dhe të sqarohen në mënyrë përkatëse brenda periudhës njëjavore, programet dyjavore brenda periudhës dyjavore dhe programet mujore brenda një muaji.

2.3 Balancimi i informatave

Programet e RTK-së që merren me çështje me interes publik dhe që krijojnë opinione të ndryshme, duhet të tregojnë pikëpamje të ndryshme në mënyrë adekuate dhe të barabartë. Adekuate dhe e barabartë në këtë kontekst do të thotë paanshmëri dhe një vëllim të arsyeshëm, duke marrë parasysh peshën e pikëpamjeve dhe të mendimeve të caktuara dhe rëndësinë e tyre.

Po të jetë e mundur, gazetari duhet të gjejë përfaqësues të të gjitha palëve dhe pikëpamjeve të përfshira dhe t'i prezentojë ato në një pjesë të lajmeve apo të programit. Nëse kjo është e pamundur, ai duhet ta informojë auditorin për këtë në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë.

2.3.1 Balancimi i informatave në një program të vetëm

Programet e veçanta që merren me një çështje madhore kundërthënëse, në parim duhet të njohin në mënyrë adekuate spektrin e mendimeve për këtë temë. Nëse jo, audiencia duhet të informohet për këtë. Ndershmëria duhet të jetë parimi kryesor në prezantim, në mënyrë që publiku të jetë në gjendje të gjykojë lidhur me çështjen në fjalë, mbështetur në fakte.

2.3.2 Balancimi i informatave në një program serik

Edhe pse programet individuale brenda një serie mund të reflektojnë një vështrim të veçantë, seritë në vetvete duhet t'u kushtojnë vëmendje të duhur këndvështrimeve të ndryshme mbi atë çështje. Synimi për të realizuar një balancim të përgjithshëm të këndvështrimeve duhet t'u prezantohet paraprakisht dhe në mënyrë të qartë shikuesve dhe dëgjuesve.

2.3.3 Balancimi i informatave në lajme dhe programe që trajtojnë çështje aktuale

Lajmet dhe programet që trajtojnë çështje aktuale duhet që mbrenda një periudhe të caktuar kohore të prezantojnë këndvështrime përgjithësisht të balancuara për çështje kundërthënëse, në mënyrë që të mos fitohet përshtypja se ato promovojnë opinione të caktuara ose se janë të manipuluar nga ngjarjet. Gazetarët dhe redaktorët duhet të jenë të vetëdijshëm për domosdoshmërinë e informatave të balancuara për çështjet kundërthënëse në prezentimet e tyre të vazhdueshme.

2.3.4 Balancimi i informatave në dramë dokumentare

Kur drama portretizon realisht njerëzit e gjallë ose situatat bashkëkohore në mënyrë kundërthënëse, ajo ka për obligim të jetë e saktë dhe t'u përmbahet fakteve kryesore. Duhet bërë një dallim i qartë midis dramave të bazuara gjerësisht në fakte ose në personazhe të vërteta dhe dokumentarëve të dramatizuar që kërkojnë të rikonstruktojnë ngjarje aktuale. Për auditorin duhet të jetë e qartë nëse ajo që ata shohin është fakt apo trillim.

Çdo rikonstruktim i një ngjarje aktuale kundërthënëse duhet t'i përmbahet standardeve të ndershmërisë. Realizimi rikrijues i disa elementeve, siç janë karakteri, dialogu dhe atmosfera, do të sjell patjetër një dimension fiktiv, por kjo nuk bën që të shtrembërojë faktet e njohura.

Saherë që kjo të jetë e nevojshme, personat e paraqitur në dramë, apo të afërmit e tyre të mbijetuar duhet të njoftohen dhe aty ku është e mundur duhet të sigurohet bashkëpunimi i tyre. Në rastet kur personat refuzojnë bashkëpunimin apo miratimin për arsye të caktuara, portretizimi nuk duhet të vazhdojë.

3 FUSHATAT ZGJEDHORE

3.1 Referimi për parlamentin dhe politikanët

Ky kapitull nuk u referohet lajmeve dhe raportimit të çështjeve aktuale gjatë periudhës zyrtare të fushatës parazgjedhore dhe as një numri të programeve të kualifikuara dhe teknike mbi rregullat zgjedhore dhe implementimin e tyre.

Gjatë fushatës elektorale, RTK-ja do të përcaktojë hapësirë kohore për të gjitha partitë politike dhe kandidatët e pavarur që garojnë për Parlament për prezentim falas, në kushte të barabarta. Rendi i paraqitjes përcaktohet përmes hedhjes publike të shortit.

Programet e RTK-së, duhet të sigurojnë kushte të barabarta për të gjithë prezentuesit: një mikrofon në studio dhe një kamerë televizive që jep të njëjtin imazh fotografik. Shfrytëzimi i materialeve me fotografi dhe zë nga arkivi i RTK-së nuk lejohet për qëllime promovuese të partive.

Partitë që duan të shfrytëzojnë prezentimin falas duhet t'ia konfirmojnë këtë me shkrim kryeredaktorit të programeve të RTK-së brenda afatit të paraparë, në përputhje me afatin ligjor të vlefshëm në këto zgjedhje.

RTK-ja, në përputhje me kërkesat programore dhe kapacitetet teknike, do të informojë me shkrim partitë politike dhe kandidatët për orarin e xhirimeve në radio dhe televizion.

Mosparaqitja në kohën e xhirit e anulon të drejtën për emetim të prezentimit falas.

3.2 Ballafaqimi i partive politike dhe kandidatëve

Programet e posaçme për partitë politike dhe kandidatët duhet t'u qëndrojnë besnike këtyre parimeve:

- a) debati duhet të ndërmjetësohet dhe të drejtohet nga gazetarë që e udhëheqin diskutimin midis përfaqësuesve të partive politike apo kandidatëve, në mënyrë të paanshme dhe pa paragjykime;
- b) gazetarët që udhëheqin me panelin e emisioneve zgjedhore janë të obliguar t'i japin pjesëmarrësit mundësinë e prezentimit brenda kohës së caktuar; pjesëmarrësit që nuk e respektojnë kohën e paraparë duhet të ndërpriten;
- c) hapësira kohore për secilin entitet politik do të bëhet në bazë të ligjit apo rregullores në fuqi;
- c) prania e partive politike në intervale të caktuara kohore në

- programe të veçanta propozohet nga ekipi redaktues i RTK-së; radha e paraqitjes së partive caktohet përmes shortit. Kjo do të mundësojë ballafaqimin e kandidatëve të partive joparlamentare me ato që janë të përfaqësuara në parlament. Në rastet kur nuk jemi të sigurtë se cilat parti kanë status parlamentar dhe cilat jo, RTK-ja është e obliguar të marrë sqarim zyrtar nga kryetari i parlamentit.
- Në emisione mund të marrin pjesë vetëm kandidatët nga listat zyrtare të një partie të vetme apo të një grupi të partive;
- d) emisionet gjatë fushatave zgjedhore zakonisht janë programe të drejtpërdrejta,
- me kohë të kufizuar për kundërpërgjigje; partitë që nuk e shfrytëzojnë kohën e caktuar për paraqitje në këtë program, nuk kanë të drejtë për paraqitje tjetër;
- e) për programet e drejtpërdrejta në studio, me pjesëmarrje të shikuesve, çdo partie i jepet një numër i njëjtë i biletave; këto bileta pastaj u shpërndahen përkrahësve të partisë, por jo edhe zyrtarëve udhëheqës, apo kandidatëve të partisë.

3.3 Balancimi i raportimit nga fushatat zgjedhore në emisione të tjera

Gjatë fushatës zgjedhore, përfaqësuesve të partive politike ose kandidatëve që garojnë për parlament nuk u lejohej të paraqiten në emisionet e RTK-së, me përjashtim të rasteve të përmendura në pikën 3.1. Kur raportohet për aktivitetet e përfaqësuesve të partive politike dhe kandidatëve që mbajnë poste qeveritare apo publike, RTK-ja duhet të bëjë dallimin e qartë midis funksioneve të tyre zyrtare dhe aktiviteteve zgjedhore.

3.4 Sondazhet e pjesëmarrësve në votim

Disa nga problemet metodologjike që përshkojnë sondazhet mbi përcaktimin e votuesit prekin gjithashtu edhe sondazhet e pjesëmarrësve në votim, megjithëse në një shkallë më të vogël: sondazhet e pjesëmarrësve në votim bazohen në intervistimet e njerëzve që sapo kanë votuar. Qëllimi i tyre nuk është që të parashohin se çka do të bëjnë njerëzit, por ato kanë për qëllim të bëjnë parashikime se çfarë do të dëshmojë deklarimi eventual lidhur me atë se çfarë kanë bërë tashmë njerëzit.

Redaktorët kanë për detyrë të vlerësojnë se sa janë këto metoda të përshtatshme para se t'i zbatojnë ato në praktikë.

RTK-ja mund të autorizojë kryerjen e sondazheve parashikuese me pjesëmarrësit në votim, vetëm nëse vlerëson se rezultatet ka të ngjarë të jenë mjaft të sigurt për të arsyetuar pretendimet që ai do t'i nxjerr nga ato.

Në emisionet mbi rezultatet e zgjedhjeve, projektimet e rezultateve të mundshme mund të bazohen qoftë duke u mbështetur në të dhëna të sondazheve të pjesëmarrësve në votim, qoftë në rezultate reale të deklaruara; por këto të dyja nuk duhet të përzihen bashkë dhe baza e kësaj projekcioni duhet t'i tregohet qartë auditorit.

Sondazhet e pjesëmarrësve në votim mund të bëhen gjithashtu për të testuar arsyet se pse ka votuar elektorati në një mënyrë të caktuar, që nuk përputhet me rezultatet e pritura.

Këto sondazhe analitike nuk kanë nevojë të kenë shkallën e saktësisë që kërkohet nga parashikimi i një sondazhi me pjesëmarrësit në votim.

3.5 Raportimi i rezultateve të zgjedhjeve

Raportimi i rezultateve të zgjedhjeve që nuk kanë si burim Komisionin Zgjedhor të Kosovës kërkon kujdes të madh.

Në raste të tilla duhet të zbatohen këto rregulla:

- a) mos e mbështetni buletin apo emisionin e lajmeve vetëm me rezultatet e një sondazhi mbi përcaktimin e votuesve;
- b) mos u bazoni në interpretimin e rezultateve të sondazhit nga një organizatë apo publikim që e ka autorizuar kryerjen e tij: shikoni pyetjet, rezultatet dhe trendin;
- c) raportoni konstatimet e sondazheve lidhur me përcaktimin e votuesve në kontekst të trendeve. Trendet mund të nxirren nga rezultatet e të gjitha sondazheve kryesore brenda një periudhe të caktuar ose mund të kufizohen vetëm në ndryshimet në konstatimet e një autori të vetëm sondazhesh. Rezultatet e votimit që nuk i përfillin trendet pa sqarime të duhura duhet të merren me skepticizëm dhe kujdes;
- d) mos përdorni atë lloj gjuhe që u jep sondazheve besueshmëri më të madhe sesa që ato e meritojnë: sondazhet "sugjerojnë", por asnjëherë nuk "dëshmojnë" apo "tregojnë";
- e) raportoni datat e sakta të punës në terren dhe vini në pah ngjarjet që mund të kenë pasur një ndikim të rëndësishëm në opinionin publik që nga koha kur ajo është realizuar (p.sh. "sondazhi i opinionit është realizuar të hënën e kaluar, para se partitë të shpallnin...")

4 MBULIMI I ÇËSHTJEVE POLITIKE, PARLAMENTIT DHE POLITIKANËVE

4.1 Programet që trajtojnë materiale mbi parlamentin dhe transmetimi

i seancave parlamentare

Materiali parlamentar mund të përdoret vetëm në lajme dhe programe faktike, apo për qëllime arsimore, për emisione të lehta zbavitëse, apo programe të tjera të RTK-së vetëm në rast të autorizimit nga kryeredaktori. Deklaratat e bëra në Parlament gëzojnë një privilegj të caktuar me rastin e raportimit dhe kjo i jep RTK-së mbrojtje nga akuzat për shpifje. Raportet nga parlamenti, që emetohen në RTK, duhet të përcjellin në mënyrë të paanshme zhvillimet në parlament, që do të thotë se ato duhet të paraqesin gjithë spektrin e opinioneve për një çështje, në mënyrë të balancuar. Në raportin e tij, gazetari duhet të informojë publikun me argumentet e një anëtari të parlamentit për dhe kundër një çështje të caktuar. Edhe pas përfundimit të seancës, nëse ajo vazhdon të zgjojë opinione kundërthënëse, RTK-ja është e obliguar t'i prezentojë ato derisa, sipas gjykimit të vet, të jenë prezentuar të gjitha opinionet relevante. Redaktimi i fjalimeve nga parlamenti duhet të dëshmojë qartë se janë shfrytëzuar dy sekuenca (pjesë) të një fjalimi, duke i ndarë ato, ose gazetari duhet të qartësojë se këto dy pjesë janë të shkëputura nga fjalimi dhe se nuk janë në vazhdimësi. Në të kundërtën do të krijohej përshtypja për manipulim. Udhëheqja e programit të RTK-së, në përputhje me konceptin e programit të miratuar nga Bordi i RTK-së, mban të drejtën të vendosë kriteret për transmetimin e drejtpërdrejtë nga parlamenti. Për shkak të rëndësisë së veçantë të disa seancave parlamentare, lajmet dhe programet e tjera që trajtojnë aktualitete, duhet të mbulojnë këto ngjarje në termine programore të përcaktuara nga udhëheqja e programit të RTK-së:

- Seanca e konstituimit të Parlamentit,
- Zgjedhja e kryetarit të Parlamentit,
- Zgjedhja e kryeministrit,
- Zgjedhja e qeverisë,
- Interpelanca ose padia kushtetuese kundër kryeministrit,
- Padia kushtetuese kundër kryetarit të Republikës,
- Seancat festive të Parlamentit.

Sipas gjykimit të redaktorit, udhëheqja merr vendim për transmetimin e seancave të tjera, që ajo i konsideron me interes.

Udhëheqja e RTK-së ka për obligim që të mos lejojë korrespondentët të japin qëndrime personale gjatë transmetimeve direkte të seancave të parlamentit.

4.2 Mbulimi i partive politike

RTK-ja, raporton për çdo ditë për aktivitetet e partive politike, prandaj edhe misioni i tij si medium publik kërkon një qëndrim të balancuar ndaj të gjitha partive.

Paraqitja e një partie politike në emisionet e RTK-së varet nga aktiviteti i saj politik. Konferencat për shtyp nuk duhet të jenë të vetmet aktivitete që RTK-ja duhet t'i përcjell. Prandaj, RTK-ja, me përjashtim të terminit të fushatës elektorale, nuk është e obliguar t'u caktojë paraprakisht partive politike kohë të barabartë. Sidoqoftë, redaktorët duhet të synojnë që mbrenda një periudhe të caktuar (zakonisht jo më tepër se një mujore)t'u **ofrojë pjesëmarrje përkatëse të gjitha partive kryesore**. Vetë redaktorët e programeve të RTK-së janë ata që vendosin, në bazë të gjykimit të vet, se cilët zyrtarë partiakë apo anëtarë të tjerë të partisë t'i ftojnë për të marrë pjesë në këto programe të veçanta. RTK-ja është e obliguar të sigurojë përbërjen e panelit të ftuar, me qëllim të ofrimit të një paraqitjeje adekuate të të gjithë rrymave kryesore politike. Kur një pjesëmarrës i ftuar refuzon, apo nuk mund të paraqitet, kjo zakonisht nuk është arsye për anulimin e emisionit. Në rast të tillë, RTK-ja do të orvatet të sigurojë një zëvendësim të përshtatshëm, në mënyrë që të paraqiten këndvështrime të ndryshme. Sidoqoftë, mund të ketë raste kur mungesa e një pjesëmarrësi të bëjë që programi të jetë i njëanshëm apo i pabalancuar dhe kështu të ndikojë në refuzimin e programit të propozuar.

Redaktorët dhe gazetarët që propozojnë intervistimin e liderëve të partive duhet që më parë të konsultohen me kryeredaktorin, me përjashtim të intervistave të shkurtra për lajme.

Në rast të emetimit të bisedave të zgjatura me kryeministrin për çështje aktuale, ne duhet t'u japim mundësi të ngjashme edhe partive në opozitë. Nëse në opozitë ka më shumë se dy parti, atëherë emetimet nuk duhet të tejkalojnë për më shumë se një herë e gjysëm kohën që kishte kryeministri, nëse është e mundur menjëherë pas paraqitjes së kryeministrit, apo në edicionin e ardhshëm të së njëjtës seri programesh.

Parti qeveritare janë të gjithë ato parti që kanë nënshkruar marrëveshjen për koalicion ose marrëveshjen për bashkëpunim në parlament, kurse parti opozitare janë të gjithë partitë e tjera, pavarësisht mënyrën se si ato votojnë për çështje të ndryshme.

Edhe nëse një anëtar partie mban një post qeveritar, por partia e tij/saj nuk është nënshkruese e marrëveshjes për bashkëpunim, ne e

konsiderojmë këtë parti si opozitare.

4.3 Terminologjia politike

Përdorimi i gjuhës në raportimet politike është shumë i rëndësishëm. Keni parasysh se fjalët ose frazat e caktuara kanë nuanca të caktuara. Për shembull, përdorimi i fjalës “pohoj” kërkon kujdes të veçantë. Ka rrezik tek lajmet e shkruara me rastin e përdorimit të fjalëve “pohon” dhe “thotë”, kur kjo bëhet vetëm për hir të ndryshimit. Nëse themi se njëra palë “thotë”, kurse tjetra “pohon”, kjo nënkupton se jemi më të prirur t'i besojmë njëres palë dhe jo tjetrës. Po ashtu, keni kujdes gjatë përdorimit të shënimeve të thjeshtëzuara, të marra ve shpejtë dhe me shkurtesa, ngaqë bindjet politike të politikanëve të vecantë dhe alternativat zakonisht kanë dimensione më të gjera.

5 STANDARDET E PRODHIMIT

5.1 Mbledhja e informatave

5.1.1 Sondazhet e opinionit

Mjafton vetëm një gabim i vogël gjatë referimit të fakteve që të dëmtohet besueshmëria e tërë programit apo e një sërë programeve. E njëjta gjë vlen për sondazhet e opinionit; prandaj sondazhet dhe rezultatet e saj duhet të zbatohen në përputhje me standardet profesionale të saktësisë, paanshmërisë dhe besueshmërisë së informatave. Sondazhet dhe anketat e opinionit nuk kryhen nga gazetarët dhe seksionet e RTK-së, por kanë një mandat më të gjerë nga institucionet dhe ekspertët kompetentë dhe të autorizuar që të kryejnë anketime të bazuara në metodat e testuara dhe standarde të pranuar. Të gjitha nismat për anketime duhet të autorizohen më parë nga kryeredaktori.

Duhet kushtuar kujdes faktit se institucionet dhe ekspertët e jashtëm nganjëherë shfaqin interesa të partive, prandaj duhet parë besueshmërinë e këtyre anketave. Prandaj, rekomandohet që sondazhet për çështje apo ngjarje madhore, si p.sh. për zgjedhjet, duhet t'u besohen së paku dy institucioneve të pavarura që merren me sondazhe të opinionit.

5.1.2 Metodat e sondazheve të opinionit

Anketimi dhe mostrat e rastit janë dy teknikat më të zakonshme që përdoren për të anketuar opinionin publik. Ato përdoren për të zbuluar fakte, për të nxjerrë në shesh qëndrime dhe për të verifikuar hipoteza.

Të dhënat e mbledhura me këto teknika paraqesin bazën e studimeve të ndryshme dhe raporteve të publikuara nga qeveria, lobistët, grupet e interesit, hulumtuesit dhe organizatat gazetareske.

Për të siguruar vlefshmërinë e këtyre rezultateve, anketimi i opinionit publik duhet të bëhet sipas metodave të testuara dhe standardeve të mirënjohura. Çdo shmangie nga këto metoda apo standarde duhet t'i bëhet e ditur publikut.

5.1.3 Emetimi i rezultateve të sondazhit të opinionit

Para se të emetohen rezultatet e ndonjë sondazhi të opinionit, nga gazetarët pritet që:

- a) të marrin të gjitha të dhënat e nevojshme për metodën e përdorur, si dhe rezultatet kryesore të anketës;
- b) të krahasojnë interpretimin e rezultateve të autorëve të studimit me mendimin e ekspertëve të tjerë në këtë fushë;
- c) të përcaktojnë vlefshmërinë e metodave të përdorura dhe të interpretimit të rezultateve.

Gjatë emetimit të rezultateve të anketës gazetari duhet:

- a) t'u kushtojë rëndësi më të madhe rezultateve sesa interpretimit të këtyre rezultateve;
- b) të raportojë emrin e personit apo organizatës që ka zhvilluar anketën dhe kur kjo është me rëndësi duhet të tregojë për lidhjet e saj me partitë politike, emrin e sponsorit, popullatën e anketuar, madhësinë e anketës, periudhen kur është realizuar kjo anketë, shkallën e përgjigjes dhe shkallën e gabimit.

5.1.3 Anketat joshkencore

Anketat që nuk udhëhiqen sipas standardeve të njohura, nuk japin rezultate të vlefshme apo informacion të besueshëm.

Kujdes të veçantë duhet pasur në prezentimin e rezultateve të mbledhura përmes intervistimit të personave të zgjedhur rastësisht, siç janë delegatët në Kuvend apo auditori përmes thirrjeve telefonike gjatë programeve, qofshin ato të drejtpërdrejta apo të incizuara më parë. Komentet e mbledhura në këtë mënyrë duhet të prezentohen vetëm për qëllim të ilustrimit të llojllojshmërisë dhe cilësisë së mendimit publik. Duhet pasur kujdes që të mos sugjerohet se prezentimet e tilla pasqyrojnë mendimin ekzistues apo peshën e opinionit brenda komunitetit për këtë apo një çështje tjetër. Po ashtu, derisa përmbajtja e komenteve mund të përmbliidhet, në asnjë rast nuk bën të jepet ndonjë shënim numerik mbi komentet që janë marrë lidhur me atë temë.

5.1.4 Votat telefonike

“Votat telefonike”, ku telefonuesit ftohen që të telefonojnë në një a disa grupe numrash telefonikë, për të llogaritur “votat” e tyre mekanikisht, ka mundësi të manipulohen nga cdo grup presioni. Ato nuk kanë vlerë informative dhe mund të jenë mashtruese.

Lajmet dhe programet faktike të RTK-së nuk bëjnë sondazhe përmes telefonit dhe nuk emetojnë rezultatet e votimeve të tilla. Përgjatë bëjnë vetëm disa programe të lehta zbavitëse, ku votimi përmes telefonave i është përshtatur metodologjisë dhe garave të tjera ndërkombëtare dhe ku mungesa e seriozitetit dhe besueshmërisë së votimit përmes telefonit balancohet me metoda të tjera të votimit dhe vlerësimit të garuesve dhe pjesëmarrësve.

5.1.5 Thirrjet telefonike

Paraqitjet me telefonata në RTK zakonisht janë të drejtpërdrejta. Kjo do të thotë se redaktorët duhet të jenë përherë të alarmuar për mundësinë e telefonuesve që thyejnë ligjin dhe që shkaktojnë ofendime në aspektin e shijes, dinjitetit apo gjuhës.

Për të minimizuar rrezikun, redaktorët duhet të udhëzojnë prezentuesit të jenë në gjendje ta nxjerrin programin nga situata të vështira me shpejtësi dhe mirësjellje. Kjo zakonisht mund të arrihet përmes ndërprerjes së lidhje telefonuesit derisa prezentuesi vazhdon diskutimin. Kur redaktori parasheh probleme për një çështje gjatë programeve me telefonata, telefonuesit, ashtu si dhe prezentuesit duhet të udhëzohen para se të fillohet me emisionin e drejtpërdrejtë.

Telefonuesit, në programe të tilla, duhet të prezentohen me emër dhe mbiemër, që është veçanërisht e rëndësishme në programet që kanë të bëjnë me probleme politike (votimi për personalitete dhe deklarata, etj.)

Prezentimi me emër dhe mbiemër nuk kërkohet domosdoshmërisht në programet e ashtuquajtura programe këshilldhënëse/informative (programet për shëndetësi, programet për bujqësi, etj.).

5.2 Intimiteti dhe mbledhja e informatave

5.2.1 Intimiteti kundrejt jetës publike

Intimiteti i një individi brenda emisioneve të RTK-së nënkupton jetën personale dhe private të individit, ndaras nga jeta e tyre publike.

Gazetarët nganjëherë mund të duket se shkelin intimitetin e individit. Kjo mund të urdhërohet vetëm nëse jeta private e individit çënon apo bëhet pjesë e jetës së tyre publike, apo bëhet çështje e preokupimit të ligjshëm publik.

Ka shumë situata kur individët nuk mund ose nuk duhet të identifikohen. Me identifikim në këtë rast kuptojmë më shumë se vetëm mosraportimin e emrit të personit. Kjo gjithashtu nënkupton mospërdorimin e fotografisë dhe mosraportimin për ndonjë detaj, përmes të cilit tërthorazi do të kuptohet identiteti i personit.

Edhe kur aferat personale të një figure publike bëhen objekt i hetimit, ata nuk humbin të gjitha të drejtat për intimitet. Gazetarët e RTK-së duhet kufizojnë veten në fakte të rëndësishme duke shmangur përgojimet. Informatat e emetuara duhet të jenë të rëndësishme dhe të vërteta. Nuk mjafton vetëm të thuhet se është interesante. Është thelbësore që të veprojmë sipas kornizës e cila respekton të drejtën e njerëzve për intimitet, që i trajton ata drejt, por që në të njëjtën kohë na lejon të hetojmë dhe të ngremë çështje që janë me interes për publikun.

Ka raste kur për prodhuesit e programeve është e pranueshme që të veprojnë në pronën private pa kërkuar leje. Nganjëherë publiku ka qasje të përgjithshme në pronën private. Hyrja pa leje nganjëherë mund të paraqes veprim të gabuar (për të cilën policia nuk ka autorizim). Sidoqoftë, në hyrjet e tilla ka rrezik për shkelje kriminale. Është me rëndësi për prodhuesit e programeve të kuptojnë detajisht ligjet e hyrjes pa leje. Pëlqimi për veprime të tilla jepet nga kryeredaktori.

5.2.2 Identiteti i të dyshimit

Gjatë raportimit për persona që janë nën hetim të policisë, duhet pasur parasysh se a është interesi i publikut apo mbrojtja e individit më thelbësore. Në raste kur informata e lëshuar nga policia ose organet e tjera të hetuesisë zbulon identitetin e të dyshimit (p.sh. inicialet e tij, etj.), deri në atë masë që e bën të vështirë për ta fshehur identitetin e tij në raport, emri i tyre dhe informatat e tjera lidhur me identitetin mund të zbulohen, por kjo kërkon miratimin paraprak të kryeredaktorit.

5.2.3 Identiteti i të akuzuarit

Kur një person i akuzuar për një vepër penale identifikohet në një emision; atëherë emetohet vetëm një pjesë e procesit gjyqësor; midis momentit të akuzimit dhe gjyqimit mund të ketë një interval të konsiderueshëm kohor.

Personeli i programit duhet të jetë i vetëdijshëm për faktin se pasojat për një person të pafajshëm mund të jenë të mëdha. Kur një i akuzuar për një rast penal identifikohet, duhet të ketë një raport përcjellës mbi vendimin gjyqësor. Programet e RTK-së do t'i kushtojnë rëndësi të

duhur faktit që i akuzuari në gjykatë të mos prezentohet në rrethana poshtruese.

5.2.4 Identiteti i viktimës së krimit

Emetimi i identitetit të viktimës së krimit në të shumtën e rasteve vetëm sa e shton pikëllimin, ankthin dhe traumën e atij personi.

RTK-ja, zakonisht nuk emeton identitetin e viktimës së krimit, veçanërisht në rastet e krimeve kundër personit, si p.sh. sulmi seksual, me përjashtim të njërës nga këto rrethana:

- a) viktima jep pëlqimin për bërjen publike të identitetit (me shkrim ose të incizuar);
- b) viktima paraqitet vullnetarisht në kronikën për emetim;
- c) interesi i publikut për çështjen është me rëndësi thelbësore.

Në rastet kur një viktima e supozuar akuzon dikë për krim kundër personalitetit të tij/saj, pa procedurë të duhur ligjore, RTK-ja nuk i siguron atij/asaj privilegjin e anonimitetit të viktimës. Për më tepër, emetimi i akuzave varet nga një rishikim tërësor nga udhëheqja e programit dhe seksioni ligjor, për besueshmërinë e personit, për provat që ai/ajo i sjell dhe vlerësimin e rrezikut për padi shpifjeje nga i akuzuari.

Me përjashtim të rastit të vdekjes së viktimës, në asnjë rrethanë tjetër RTK-ja nuk identifikon të miturin që është viktima e krimit.

5.3 Mbrojtja e burimeve të informacionit

RTK-ja mbështet fuqimisht parimin e mbrojtjes së burimeve të gazetarit. Informatat për të cilat publiku duhet të dijë nganjëherë sigurohen vetëm përmes burimeve të fshehta. Gazetarët diskutojnë shpesh jozyrtarisht, me figura publike dhe personalitete të tjera. Nëse fshehtësia e burimit të informatës nuk ruhet për shkak të parimit, kjo do të ndalonte rrjedhjen e lirë të informatave, që është esenciale për vitalitetin e shoqërisë demokratike.

Informacionet nga një burim që nuk do të identifikohet publikisht, mund të përdoren nga gazetari, nëse burimi i informatës është i njohur për të dhe nëse ato kanë besueshmërinë *prima facie*. Sidoqoftë, për të shmangur mundësinë e manipulimit në emetimin e informatave të pasakta ose të paragjykuara, gazetari duhet të kontrollojë me kujdes sigurinë e burimit dhe duhet të sigurojë prova konfirmuese edhe nga të paktën dy burime të tjera përkatëse.

Bërja publike e burimeve të informatave brenda linjës gazetareske të përgjegjësisë nuk duhet të përzihet me zbulimin publik të burimeve. Kryeredaktori duhet ta trajtojë atë informatë me fshehtësi absolute. Nëse kryeredaktori konsideron se raportit i mungon një element për ta bërë atë të besueshëm dhe të saktë, ai ose ajo mund ta refuzojë emetimin e një lajmi të tillë.

Mbrojtja e burimeve është një e drejtë etike profesionale, e cila, ashtu si dhe profesionet e mjekut dhe juristit, janë të lidhura me detyra dhe të drejta të veçanta.

Mbrojtja e burimeve nuk është e drejtë ligjore dhe, veçanërisht kur bëhet fjalë për sigurinë publike ose për ndonjë krim, gjykatat dhe organet e tjera gjyqësore mund t'i kërkojnë një personi të zbulojë burimet e tij të informatave. Në raste të tilla, RTK-ja nuk do ta këshillojë punëtorin e vet të refuzojë t'i bindet urdhërit të gjyqit. Sidoqoftë, këshilltari ligjor i RTK-së do të jetë në dispozicion për këshillim dhe mund t'i kërkojë gjyqit që ta peshojë me kujdes interesin e publikut, para se të urdhërojë thyerjen e fshehtësisë gazetareske, ose nëse gjyqi insiston në urdhërin e vet, këshilltari ligjor i RTK-së mund të kërkojë që dëgjimi të bëhet para kamerës.

5.3.1 Pjesëmarrësit anonim në program

Saktësia dhe integriteti në gazetari kërkon që identiteti dhe kredencialet e një të intervistuari të jenë të dukshme për publikun.

Nëse një i intervistuar apo pjesëmarrës në program është anonim, nëse fytyra ose identiteti i tij fshihen, ose zëri është ndryshuar, kjo është e barabartë me fshehjen nga publiku të informatave përkatëse për të gjykuar komentet e personave dhe mund të shtojë mundësinë e deklaratave të papërgjegjshme nga pjesëmarrësi.

Ka raste kur vlera e informatave (që matet me rëndësinë e sjelljes së informatës në vëmendjen e publikut) që përcillet përmes një të intervistuari ose pjesëmarrësi tjetër anonim, është më e madhe nga kundërshtimet ndaj një paraqitjeje anonime dhe në raste të tilla kjo metodë mund të arsyetohet.

Në rastet kur kërkohet të bëhet një intervistim anonim, duhet të sigurohet miratimi i kryeredaktorit të programit informativ.

5.3.2 Refuzimi i paraqitjes në program

Çdokush ka të drejtë të refuzojë të paraqitet në program. Kur auditori pyet me të drejtë se pse një person nuk është paraqitur në program, atëherë do të ishte e drejtë të sqarohet refuzimi i tij.

5.3.3 Embargot

Redaktorët dhe gazetarët duhet të respektojnë embargot në një material të caktuar. Nganjëherë është e mundur që të bindet burimi i informatave që të heq apo të ndryshojë embargon e tij. Nëse embargot shkelen nga mediumet e tjera, RTK-ja do ta konsiderojë atë si arsyetim për të vepruar në po atë mënyrë.

5.4 Lajmet

Lajmet janë kategori themelore gazetareske. Lajmet duhet të jenë të

qarta, të sigurta, të sakta dhe të hapura për vërtetim. Lajmet nuk duhet të përmbajnë elemente të komentimit. RTK-ja përmbahet nga emetimi i të ashtuquajturave lajme të komentuara, të cilat mund të jenë paragjykuese ose mashtruese. Aty ku nuk është e mundur të kontrollohen të gjitha faktet, burimet e lajmeve duhet të citohen qartë (agjencitë me kredibilitet, etj.).

5.5 Raportimet

Raportimet janë kategoria më e përhapur në programin informativ. Reporterët dhe autorët e lajmeve duhet të raportojnë në bazë të fakteve. Të gjitha faktet që raportohen duhet të verifikohen; aty ku verifikimi nuk është i mundur, duhet të emërojmë burimin qartë. Raportet nuk përmbajnë elemente të komentimit dhe RTK-ja përmbahet nga emetimi i raporteve të komentuara.

5.5 Intervistimet

Intervistuesi mund të informojë të intervistuarin para intervistimit për qëllimin e bisedës. Të intervistuarit duhet t'i jepen disa indikacione për sa i përket kohës së intervistës që do të përfshihet në program, duke i bërë të ditur se kohëzgjatja nuk është më tepër se ajo e llogaritur dhe se, në disa raste, biseda mund të mos përdoret fare. Kur bëhen intervistime, RTK-ja duhet të silltet në përputhje me kushtet me të cilat është pajtuar para intervistimit.

Kur dy ose më shumë njerëz intervistohen në mënyrë individuale për të njëjtin program ose seri të programeve, asnjë pjesëmarrës nuk duhet të lejohet të shohë apo të dëgjojë komentet e tjetrit.

I intervistuari duhet të informohet për përmbajtjen e intervistës por nuk mund t'i jipen pyetjet që më parë.

Kushdo që shpreh qëndrime të diskutueshme gjatë intervistimit duhet të kontrollohet rigorozisht. Njerëzit në pushtet dhe ata që kërkojnë të vijnë në pushtet, ata që mbrojnë ose kritikojnë politika të caktuara, duhet qasur me një ton përmbajtës. Intervistimet në RTK nuk duhet të duken sikur janë në favor të një qëndrimi të caktuar, nëse qëndrimi i tillë është kundërthënës. Ato duhet të jenë profesionale: të hulumtojnë përgjigjet dhe të sqarojnë dilemat. Gazetarët duhet t'i shmangen përshtypjes së animit, përmes ndryshimit të intonacionit ose përmes fjalëve të pakujdesshme. Nëse një bisedues refuzon që të intervistohet pa u marrë vesh për pyetjet që do t'i bëhen paraprakisht, atëherë prodhuesit e programeve duhet të shqyrtojnë me kujdes nëse ia vlenë që të vazhdohet më tutje. Nëse vendosin të vazhdojnë, ata duhet t'i paraqesin qartë në emision kushtet, në të cilat është realizuar intervista.

Jo të gjithë intervistat janë sfiduese. Disa intervista bëhen me qëllim

informimi, sqarimi ose zbavitje. Teknikat e përshtatshme për këtë qëllim janë të ndryshme. Njerëzit që intervistohen si dëshmitarë ose si ekspertë duhet të inkurajohen, në vend se të sfidohen. Në rast intervistimesh të partive me pikëpamjeve të ndryshme të të njëjtit subjekt, redaktorët janë të obliguar që palës tjetër t'i japin mundësinë e kundërpërgjigjes në edicionin e ardhshëm të programit. Kur intervistimi incizohet për edicionin e mëvonshëm, të intervistuarit duhet të trajtohen me drejtësi. Kjo përfshin edhe sqarimin se intervista e tyre do të emetohet. Të intervistuarit që i kërkohet të përgjigjet në kritika të vecanta të bëra ndaj tij, duhet dhënë mundësia që të përgjigjet në secilën prej pikave kryesore të përmbajtjes në incizimin e plotë. Përzgjedhja vetëm e përgjigjeve të dobëta të të intervistuarit është e padrejtë.

Programet duhet të jenë të kujdesshëm kur pajtohen ta paraqesin si të "drejtpërdrejtë" një intervistë që do të xhirohet. Rrethanat mund të ndryshojnë para transmetimit, gjë që do ta bënte të papërshtatshëm shfrytëzimin e incizimit në tërësi.

5.6.1 Intervistat përmes telefonit

Personi që thirret në telefon duhet të informohet për qëllimin e intervistës dhe të merret leja nga ai përpara emetimit të intervistës.

Kur këto intervista, përmes telefonit, bëhen ballë për ballë midis partive të ndryshme për një çështje, të dy të intervistuarit duhet që para fillimit të intervistës të njoftohen për prezencën e njëri-tjetrit, dhe nëse autorizohet, duhet të ofrohet mundësia për një replikë të shkurtër.

Kur tema ka të bëjë me një çështje që është kundërthënëse për publikun, balancimi është i domosdoshëm.

5.7 Komenti

Misioni i RTK-së kërkon që të informojë audiencën sa më gjerë që është e mundur në mënyrë të balancuar dhe të paanshme për ngjarjet me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndonëse gazetarët mund të kenë formësuar mendime të veta të caktuara lidhur me një çështje për të cilën ata raportojnë, gjatë raportimit ata assesi nuk mund të shfrytëzojnë vetëm ato fakte që u përshtaten mendimeve të tyre personale. Me rastin e emetimit të mendimeve subjektive të gazetarëve, kjo duhet t'i bëhet e qartë auditorit. Meqë mendimi subjektiv shpesh mund të bazohet në fakte të caktuara, redaktorët duhet të sigurohen që skemat dhe përmbajtjet e komenteve të jenë sa më pluraliste që është e mundur. Komentet duhet të jenë të balancuara duke përfshirë të gjitha këndvështrimet kryesore për një çështje. Asnjë gazetar apo redaktor i punësuar në RTK nuk ka monopol mbi komentet. E njëjta gjë vlen edhe për komentatorët e

pavarur.

5.8 Pagesat

Zakonisht, RTK-ja nuk paguan burimet e lajmeve.

5.8.1 Pagesa për burimet e lajmeve

Nëse ka ndonjë përjashtim kur parashihet pagesa e burimeve, nevojitet miratimi i kryeredaktorit. Fakti se këto pagesa janë bërë duhet të raportohet në emetim.

5.8.2 Pagesa e honorarve

Nga ana tjetër, ka një kërkesë, që në rrethana të caktuara, të paguhen personat që u kërkohet të marrin pjesë në programet informative. Përcaktimi i pagesave të tilla bëhet në bazë të shkallës ekzistuese të punëtorëve në RTK.

5.8.3 Pagesat e anëtarëve të parlamentit, këshillëtarëve shtetëror, ministrave dhe zyrtarëve të partive politike

RTK-ja nuk do të bëjë asnjë lloj pagese për asnjë arsye për zyrtarët e përmendur. Kjo ndalesë vlen për të gjitha pagesat, përfshirë edhe honoraret për paraqitje, të drejtat e dorëshkrimeve, shpenzime udhëtimi apo jetese, ose shpenzime të tjera që duhet t'i bëjnë ata vetë.

5.9 Mbulimi i ngjarjeve të veçanta

5.9.1 Mbulimi i demonstratave

Ka shumë forma për të zbatuar të drejtën për protesta dhe demonstrata, përfshirë marshimet, okupimin e ndërtesave dhe vendeve të tjera, rrethimi i vendeve me grevistë, qëndrimi ulur, grevat e urisë dhe iniciativa të tjera të ngjashme nga individë dhe grupe.

Shumë ngjarje publike planifikohen dhe realizohen përmes tërheqjes së vëmendjes mediale dhe mbulimit medial të këtyre aktiviteteve. Përjashtim nga kjo nuk bëjnë as protestat dhe demonstratat. Shprehja e të drejtave dhe lirive të tyre nga ana e protestuesve nuk duhet të rezultojë në humbjen e lirive dhe të drejtave të tjerëve, përmes veprimit të RTK-së.

Mundësia për manipulime gjatë mbulimeve të tilla shpesh është e madhe. Gazetarët e RTK-së duhet t'i respektojnë këto udhëzime:

- a) Vendimi për të mbuluar demonstratat nuk duhet komunikuar askujt jashtë RTK-së. Vendimi për mbulimin medial të një ngjarje të tillë mund të ndikojë në pjesëmarrje dhe planifikim.
- b) Gazetarët duhet të mbajnë në distancë organizatorët dhe

demonstruesit dhe të mos lejojnë që raportimi i tyre të duket i njëanshëm. Redaktorët duhet të kenë kujdes që për këto detyra të caktojnë gazetarët dhe reporterët më të mirë që i kanë në disponim.

- c) Ekipet raportuese duhet të kenë kujdes ndaj personave apo grupeve që manifestojnë qartë para kamerave apo mikrofonëve.
- d) Ekipet e raportimit nuk duhet t'u bëjnë ndonjë propozim ose kërkesë demonstruesve që do të mund t'u jepte një kahje tjetër ngjarjeve.
- e) Gazetarët duhet të hetojnë dhe të raportojnë për identitetin e organizatorëve, qëllimin e demonstratave dhe numrin e pjesëmarrësve.
- f) Kur një ngjarje e planifikuar publike çrregullohet nga demonstratat, ngjarja megjithatë duhet të ketë mbulesën mediale që i takon.
- g) Vendimi për emetimin e raportit duhet të bazohet më shumë në rëndësinë e ngjarjes, protestës ose demonstratës sesa në zërat dhe imazhet që ajo krijon.
- h) Reporterët dhe redaktorët që mbulojnë demonstratat apo trazirat duhet të jenë shumë të kujdesshëm dhe të mos lejojnë që në transmetime të drejtpërdrejta të përdoret gjuha e urrejtjes nga ana e pjesëmarrësve në demonstrata apo trazira. Nëse kjo megjithatë ndodhë, ata duhet të intervenojnë dhe të distancohen në mënyrë të qartë, apo edhe të ndërpresin transmetimin e drejtpërdrejtë.
- i) Reporterët dhe redaktorët që mbulojnë ngjarje të jashtëzakonshme duhet të jenë shumë të kujdesshëm në citimin dhe verifikimin e burimeve dhe të fakteve. Nëse nuk janë të sigurtë, ata duhet të konsultojnë së paku dy burime të pavarura.
- j) Redaktorët përgjegjës duhet të jenë shumë të kujdesshëm në vendimet e tyre për transmetim të drejtpërdrejtë të demonstratave. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm se edhe demonstratat paqesore, në rrethana të caktuara sociale e politike, mund të shndërrohen në trazira të dhunshme, veçanërisht kur vendi përballlet me jostabilitet politik.
- k) Redaktorët duhet të bëjnë çmos që të parandohen thirrjet publike për trazira nëpërmjet televizionit apo radios, sidomos kur është fjala për transmetime të drejtpërdrejta.

5.9.2 Trazirat qytetare

Në disa raste të trazirave apo turbullirave qytetare, është e qartë se

prezenca e kamerave dhe mikrofonëve mund të provokojë dhunë. Kur bëhen plane për mbulimin e ngjarjeve në të cilat mund të pritet dhunë qytetare, duhet të merren masa paraprake të kujdesit për t'u siguruar që prezencat e gazetarëve të RTK-së, kamerat ose mikrofonët të mos kuptohen si provokim. Nëse prezencat e tyre nxit një situatë potencialisht të rrezikshme, ata duhet të ndalojnë përdorimin e aparateve për incizim e, në disa raste, edhe t'i fshehin ato.

5.9.3 Terrorizmi

Gazetarët e RTK-së duhet të sigurohen se me veprimet e tyre nuk rrezikojnë edhe më tepër jetërat e pengjeve ose që të mos ndikojnë në përpjekjet e autoriteteve që të sigurojnë lirinë e tyre.

Me rastin e raportimit nga një akt terrorist, gazetarët e RTK-së dhe ekipi i kameramanëve duhet të respektojnë këto udhëzime:

- a) Çdo komunikim direkt nga terroristët/pengmarrësit që përmban informata për aktet e tanishme terroriste apo atyre të planifikuara për më vonë, duhet t'i raportohet menjëherë kryeredaktorit të programit informativ.
- b) Asnjë incizim i drejtëpërdrejtë i ndonjë deklaratë apo interviste me terroristët/pengmarrësit nuk bën të emetohet pa autorizim të kryeredaktorit të programit informativ. Ky autorizim do të jepet vetëm në raste të rralla.
- c) Deklaratat ose kërkesat e terroristëve/pengmarrësve paraqesin pjesë përbërëse të këtij incidenti. Megjithatë, në të shumtën e rasteve, kjo duhet të emetohet në përmbledhje ose në formë të redaktuar për të shmangur rrezikun nga manipulimet.
- d) Telefonatat ose kontaktet e tjera direkte me pengjet ose terroristë/pengmarrësit, ose me të dy palët, duhet të bëhen vetëm nëse, sipas gjykimit të kryeredaktorit të programit informativ, ky aktivitet nuk ka ndikim në komunikimet e autoriteteve dhe nëse një veprim i tillë nuk e vë në rrezik sigurinë e pengjeve.

5.10 Raportimi i krimit dhe aksidenteve

Kur raportohet për krimet dhe aksidentet, duhet të përmbahemi nga senzacionalizmi. Televizioni dhe radio mund të shtojnë frikën e njerëzve se do të bëhen viktimat e krimit. Ne duhet të përpiqemi ta shmangim krijimin e panikut të pabazë, por duhet të përpiqemi për mbulim të balancuar të krimit, duke i ndërgjegjësuar njerëzit për rrezikun e krimit të dhunshëm. Kur raportojmë për krimin, duhet të kemi parasysh se e drejta për informim nuk duhet të jetë mbi të drejtën e individëve për intimitet.

5.10.1 Mjetet profesionale

5.10.1.1 Teksti

Teksti duhet të përqëndrohet në fakte. Parimi se çdokush është i pafajshëm derisa gjyqi nuk e shpall fajtor, vlen këtu. Kur raportojmë për aktet kriminale, ne mund të flasim për të dyshuar, jo për kriminel. Kur nuk kemi informata në dispozicion nga burime zyrtare, duhet ta bëjmë të ditur se nga cilat burime janë mbledhur informatat e përdorura nga gazetarët.

Për shembull, ne nuk mund të themi: "thuhet...", "fjala është për...", por duhet të citojmë: "fqinjët e viktimës thonë", "bashkëfshatarët pohojnë", "dëshmitarët na siguruan se ata panë...", etj.

Gazetari do të preferojë të mbështetet në zbulimet e autoriteteve hetuese, policisë dhe ekspertëve.

Aty ku gazetari sheh pasiguri, kontradikta, mashtrim, pasivitet ose devijim në hetimet e një zyrtari dhe që ka mbledhur mjaft material për hetim paralel gazetaresk, duhet ta informojë kryeredaktorin.

Burimet zyrtare publikojnë inicialet e të dyshuarve. Kur bëhet fjalë për figura publike (të politikës, sportit, shou-biznesit, etj.), mund të publikohet emri i plotë pas miratimit paraprak të kryeredaktorit. Duhet referuar burimit të lajmit.

5.10.1.2 Fotografia

Gjatë incizimit dhe emetimit të raporteve mbi krimin duhet pasur parasysh se nuk është në përputhje me standardet tona profesionale dhe etike:

- a) Shfaqja e viktimave të pambrojtura, fotografive të gjakut në fytyrë nga afër, kufomave, etj.; skenat e tilla duhet të xhirohen nga distanca, ku detajet që zbulojnë identitetin e viktimës nuk duken. Një këshillë që mund t'u ndihmojë në zgjedhjen e skenës që duhet emetuar: fotografuesi dhe redaktori duhet të jenë të mësuar me gjendjet emocionale të të afërmeve të cilët kuptojnë për aksidentin në televizion.
- b) Shfaqja e targave të veturave, numrave të shtëpive dhe detajeve të tjera që mund të zbulojnë identitetin e viktimës në mënyrë indirekte; e njëjta gjë vlen edhe këtu: fotografuesi (xhiruesi) dhe redaktori duhet të zgjedhin figura që nuk mundësojnë identifikim e viktimës.
- c) Shfaqja e paraqitjes së të akuzuarit në gjykatë, gjatë kohës kur është në arrest, përpara shpalljes së vendimit, me përjashtim kur ajo ndodhë në gjyq me urdhër të gjyqit.

6 RAPORTET NDAJ AUTORITETEVE SHTETËRORE NDERKOMBETARE DHE TE PERKOHSHME/ORGANEVE QEVERITARE

RTK-ja vepron në përputhshmëri me rregulloren e UNMIK-ut 2001/13, 2000/19 si një shërbim medial publik, autonom dhe i pavarur. Udhëheqja e programit dhe gazetarët bashkëpunojnë (në kuadër të kornizës Kushtetuese për vetadministrim në Kosovë) me organet ndërkombëtare apo të përkohshme qeveritare/organet zyrtare në nivel të barabartë dhe nuk marrin e as nuk zbatojnë urdhërat ose udhëzimet e tyre.

Programet e RTK-së raportojnë në mënyrë të plotë dhe të hollësishme për punën e UNMIK-ut, OSCE-së, KFOR-it, qeverisë së përkohshme dhe organeve të tjera zyrtare dhe mbulojnë aktivitetet e tyre me saktësinë e duhur kurse në hollësi këndvështrimet e opozitës dhe përfaqësuesëve të shoqërisë civile.

Redaktorët dhe gazetarët duhet të mbajnë distancë profesionale ndaj të gjitha instrumenteve të qeverisë, sepse në të kundërtën, ajo mund të rrezikojë integritetin e institucioneve për të cilat ai punon.

Dispozitat ligjore mbi shtetin dhe sekretet ushtarake obligojnë zyrtarët dhe institucionet që i mbajnë keto dokumente. Një sekret ushtarak ose zyrtar, në rrethana të caktuara, mund të shërbejë si mbulesë për interesa të individëve, grupeve ose shërbimeve të caktuara për të fshehur fakte të rëndësishme ose veprime ilegale nga publiku.

Publikimi i një dokumenti që mund të rrezikojë sigurinë shtetërore duhet të vendoset me shumë kujdes dhe shkallë të lartë profesionalizmi nga ana e kryeredaktorit në marrëveshje me drejtorin e programit.

6.1 Raportet ndaj armatës

Gjatë mbulimit të çështjeve ushtarake, udhëheqësia e programit të RTK-së respekton parimet demokratike se armata i nënshtrohet autoritetit civil.

6.2 Raportet ndaj policisë

RTK-ja i ndihmon publikut përmes emetimit të mesazheve policore apo njoftimeve për probleme në komunikacion ose raste emergjente. Programi i lajmeve, në veçanti në nivel rajonal dhe lokal, zakonisht përcjell apelet e policisë për informata lidhur me ndonjë krim serioz.

Programet e RTK-së paraqesin policinë në të njejtën mënyrë si dhe organet e tjera shtetërore. Programi informativ duhet ta shqyrtojë

rolin e policisë në mënyrë të paanshme.

Disa forca policore u lejojnë grupeve të gazetareve t'i shoqërojnë policët gjatë detyrave të posaçme. Redaktorët dhe gazetarët duhet t'i shqyrtojnë arsyet për dhe kundër pranimit të këtyre ftesave. Ka një dobi të qartë publike kur shihet se si zbatohet një operacion, por këtu ka edhe rreziqe. Një ngjarje e tillë parimisht synon që të krijohet publicitet i favorshëm; ajo mund të ofrojë qasje vetëm në një pjesë të një operacioni më të madh; mbulesa e operacioneve të tilla ka rrezik ta bëjë vetë mediumin të duket si pjesë e operacionit.

Policia mund të përpiqet të sigurojë qasje në materialet e patransmetuara, të incizuara gjatë hetimit të ndonjë aktiviteti kriminal. Redaktorët dhe gazetarët duhet të kenë parasysh se mund të ballafaqohen me këto çështje përpara se të vendosin të shkojnë në ndonjë operacion. Redaktorët e RTK-së mund t'ia dorëzojnë policisë xhirimet e bëra nga kamermani i RTK-së vetëm nëse ato kërkohen zyrtarisht me anë të një vendimi kompetent gjyqësor me justifikim për akcionin.

7 SJELLJA IMITUESE DHE ASOCIALE

Auditori është i preokupuar me mundësinë që njerëzit të imitojnë sjelljet që ata

i shohin dhe dëgjojnë në televizion ose radio. Ne duhet të përpiqemi të sigurojmë që sjelljet asociale, ose kriminale, të paraqitura në programe të mos kopjohen dhe një kujdes i veçantë duhet kushtuar kur flasim për teknikën kriminale.

Raportimet faktike mbi një vrasje ose vetëvrasje duhet të shmangin detajet grafike. Programet duhet të shmangin vëmendjen nga metodat e caktuara të vrasjes. Kujdes i veçantë duhet kushtuar shikimeve redaksionale për ndonjë dramë që duket se eksploaton ose lavdëron vrasjet dhe vetëvrasjet.

Konsumimi i duhanit dhe alkoolit në programet për fëmijë të RTK-së duhet shmangur. Në dramat dhe programet faktike, ka raste kur konsumimi i duhanit është esencial për personazhin e një ngjarjeje.

Në programet e përgjithshme, siç janë debatet në studio, ndalohet konsumimi i duhanit si edhe ai i çfarëdolloj medikamenti apo i alkoolit. Në programet e RTK-së nuk duhet të inkurajohet konsumimi i alkoolit.

7.1 Metodat klandestine të grumbullimit të lajmeve

Metodat e klandestine të grumbullimit të lajmeve duhet të përdoren vetëm në rast se ka bazë ligjore për to, duke marrë në konsideratë

ndershmërinë dhe ndërhyrjen në intimitet dhe nëse informata të cilën dëshirojmë ta kemi është e një rëndësie të madhe për publikun, por që nuk mund të merret me mënyra të tjera.

7.2 Keqprezentimi

Mashtrimi nuk duhet të shfrytëzohet për marrjen e informatave. Të punësuarit në RTK, nuk duhet të fshehin identitetin e tyre për të arritur deri tek informatat.

Siodqoftë, mund të ketë raste kur një gazetar, për qëllime legjitime të programit, nuk e deklaron profesionin e tij/saj, por kërkon informata si një pjesëtar i thjeshtë i publikut. Këto hetime bëhen zakonisht jashtë vendeve ku ka qasje publiku i rëndomtë.

Nëse konsiderohet e rëndësishme dhe në interes të publikut që të kërkojë informata pa e treguar qëllimin gazetaresk, në vendet në të cilat publiku zakonisht nuk ka qasje, duhet të merret miratimi i kryeredaktorit të programit.

7.3 Kamerat dhe mikrofonët e fshehur

Si rregull, kamerat dhe mikrofonët e fshehur nuk duhet të përdoren në mbledhjen e informatave.

Mund të ketë raste kur përdorimi i këtyre mjeteve të fshehta incizimi mund të quhet i rëndësishëm për publikun. Rastet e tilla, p.sh. mund të përfshijnë raportin mbi shitjen e drogës në rrugë.

Edhe kur është e arsyeshme, incizimet e fshehta rrezikojnë të dëmtojnë besimin e publikut në RTK. Për këtë arsye, autorizimi paraprak duhet të sigurohet nga kryeredaktori i programit. Autorizimi mund të jepet vetëm nëse informacioni i marrë i shërben një qëllimi të rëndësishëm, është i domosdoshëm për atë qëllim dhe nuk mund të realizohet në ndonjë mënyrë tjetër. Për më tepër, ajo duhet të përdoret në rastet e krimeve të rënda.

Programet zbavitëse dhe programet e tjera të ngjashme mund të përmbajnë sondazhet e rrugëve dhe nëse njerëzit të cilët janë intervistuar në këto incizime e kanë dhënë pëlqimin e tyre para se materiali të emetohet.

7.4 Rrjedhja e informatave zyrtare/sekrete

Rrjedhja e informatave nga institucionet qeveritare është formë e veçantë e informimit anonim që përdoret kur zyrtarët e caktuar shtetërorë dëshirojnë të informojnë publikun për tema konfidenciale. Kjo informatë mund të jetë e dobishme, por bartë në vete edhe mundësinë e mashtrimit, meqë synimi kryesor i informuesve nuk është gjithnjë të zbulojnë të vërtetën. Prandaj publikimi i një informate të tillë është gjithmonë një sfidë etike për redaktorët dhe gazetarët. Informata nga burimet e tilla duhet të kontrollohet me kujdes për sa i

përket besueshmërisë dhe qëllimit. Sidoqoftë, ajo mund të paraqesë pjesë të rëndësishme të raportimit të lajmeve.

8 GAZETARIA HULUMTUESE

Gazetaria hulumtuese kërkon aftësi të mëdha si dhe ruajtjen e aplikimin strikt të standardeve të saktësisë. Gazetaria hulumtuese nuk guxon të kryhet pa burime adekuate dhe pa kohën e nevojshme për hulumtim deri në fund.

Programet mund të drejtojnë auditorin të nxjerrë konkludime për temën e trajtuar. Këto duhet të jenë konkludime logjike të nxjerra nga faktet e jo nga shprehja e opinionit redaktues ose nga metoda jo të drejta të prezentimit. Është esenciale, që në përputhje me parimet e saktësisë, integritetit, drejtësisë dhe gjithëpërfshirjes, programet të bazohen në hulumtim shumë të detajuar dhe të drejtë. Ato duhet të marrin parasysh të gjitha faktet relevante të mundshme dhe të njohin edhe spektrin e mendimeve në lidhje me çështjen në fjalë.

Mundësia për reagim është esenciale për programin hulumtues. Në interes të drejtësisë, duhet t'u ofrohet mundësia të gjitha palëve të prekura drejtpërdrejtë për të deklaruar qëndrimin e tyre.

Për të shmangur mundësinë e të qenit të manipuluar nga informatat e pasakta ose të paragjykura, gazetari duhet të kontrollojë me vëmendje besueshmërinë e burimit dhe të sigurojë fakte vërtetuese nga burimet të tjera që kanë të bëjnë me çështjen.

9 PËRPUNIMI I INFORMATAVE

9.1 Nikoqirët dhe intervistuesit

Nikoqirët dhe intervistuesit duhet t'i trajtojnë mysafirët e tyre në mënyrë të drejtë. Ata nuk duhet të jenë kritikë apo kërkues ndaj disave, ndërsa pajtues dhe përkrahës ndaj të tjerëve. Është gjithashtu esenciale për ruajtjen e besueshmërisë që ata të përmbahen nga qëndrimet personale, jo vetëm në deklaratat e tyre, por gjithashtu edhe në mënyrën e udhëheqjes së bisedës dhe zgjedhjes së pyetjeve.

9.2 Raportuesit

Roli i raportuesit është që t'i transmetojë publikut lajmet me korrektësi, saktësi dhe ndershmëri maksimale.

Duke ofruar mbulim gjithëpërfshirës, raportuesit mund të dëshirojnë të ofrojnë edhe kontekstin e lajmeve dhe ngjarjeve. Për këtë qëllim, ata mund të japin ndonjë shpjegim historik të ngjarjes, bazuar në hulumtim të kujdesshëm. Mirëpo, ata nuk mund të shprehin apo të paraqesin mendimin e tyre personal ose të paragjykojnë.

Qëllimi i prezentimit të kontekstit dhe analizës është që të sigurohemi që auditorit, i cili mbështetet në gazetarinë transmetuese, si burim parësor i informacionit, t'i jepet një shpjegim sa më i qartë i ngjarjeve në lajme, i personaliteteve dhe çështjeve.

9.3 Komentatorët mysafirë

Sipas definicionit, komentatori mysafir është i ftuar për të dhënë mendim lidhur me çështje shoqërore. Për shkak të karakterit të tij si institucion publik, RTK-ja nuk i pranon si të vetat mendimet e këtyre komentatorëve, të cilët i fton për të artikuluar alternativa të ndryshme të mendimit aktual në temën e dhënë. Preokupim i RTK-së është të sigurojë prezentimin e një spektri të gjerë mendimesh, posaçërisht kur kemi të bëjmë me çështje shumë kundërthënëse, prandaj RTK-ja zgjedh komentatorë, përgatitja e të cilëve i kualifikon ata të japin mendime ekspertësh, bazuar në informacione të sakta.

Cdo aspekt i bindjeve personale të komentatorit duhet të prezentohet qartë, në mënyrë që auditori të ketë një këndvështrim nga i cili do të vlerësojë pikëpamjet e folësit. Për shembull, duhet cekur pozita dhe grupacioni, të cilit i takon, ose ndonjë kualifikim i ligjëruesit a ndonjë folësi tjetër. Përshkrimet "tranmestues i pavarur" apo "shkrimtar i pavarur" nuk e plotësojnë këtë kusht.

9.4 Redaktimi

Procesi i redaktimit duhet të rezultojë në paraqitje reale të asaj që me të vërtetë është parë dhe dëgjuar.

Pavarësisht nga kufizimet kohore të vendosura nga producentët e radios dhe televizionit, redaktimi i artikujve duhet të jetë i qartë dhe konciz.

Ajo që me të vërtetë rezulton nga seleksionimi dhe redaktimi është një realitet i përmbledhur, një pjesë e realitetit, e cila duhet të reflektojë patjetër të vërtetën esenciale, pa shtrembërime.

9.5 Redaktimi i intervistave

Këto janë udhëzimet e rëndësishme për redaktimin e intervistave:

- a) Pyetjet dhe përgjigjet nuk duhet të redaktohen, që të mos ndërrohet domethënia origjinale, ose që të mos shtrembërohet sensi i intervistës si tërësi.
- b) Përgjigjet e dhëna në një kontekst nuk duhet të redaktohen në një kontekst tjetër.
- c) Përgjigja në pyetje nuk duhet të vendoset në atë mënyrë që të kuptohet si përgjigje në ndonjë pyetje tjetër nga ajo që në të vërtetë i është parashtruar.
- d) Në rastet kur procesi i redaktimit kërkon përsëritje të pyetjeve, reagime ose fshirje, duhet të ruhet natyra dhe qëllimi i reagimit original.
- e) Dëgjuesit dhe shikuesit nuk duhet të mashtrohen kinse midis njerëzve po bëhet një bisedë, kur nuk është incizuar ndonjë bisedë e tillë.
- f) Për shkak të ndershmërisë dhe profesionalizmit, intervistave të incizura nuk duhet shtuar, ndryshuar, shtrembëruar asgjë nga ato që kanë thënë dhe nuk duhet futur pyetje të reja nga intervistuesi.

9.6 Shfrytëzimi i materialit arkivor

Në rast se materiali audio-vizuel është incizuar shumë më herët nga emetimi i programit, posaçërisht nëse pikëpamjet e folësit ose informacioni i ditur ka ndryshuar në ndërkohë, kjo duhet bërë e ditur auditorit.

Rishfrytëzimi i intervistës ose pjesëve të intervistës duhet të bëhet në atë mënyrë që konteksti i intervistës fillestare të mos shtrembërohet.

9.7 Shfrytëzimi i teknologjisë në redaktim

Efektet speciale, përfshirë efektet e zërit, duhet të përdoren me kujdes të veçantë në prezantimin e materialit gazetaresk. Në raste të rralla, kur ato janë përdorur, kjo duhet të bëhet me kujdes rigoroz për t'u siguruar se ato nuk e shtrembërojnë realitetin ose që të mos kenë efektin e prodhimit të komentit redaktues.

Saktësia dhe besueshmëria mund të kompromitohen nga abuzimi i teknologjisë së radios dhe televizionit, që ofrojnë llojllojshmëri të efekteve audio dhe vizuele, për të modifikuar atë që emetohet.

Programet informative të RTK-së, duke përfshirë programet informative në kulturë dhe sport, duhet t'u shmangen përdorimit të efekteve speciale dezorientuese, të mundësuar nga teknologjia analoge e radios dhe televizionit, si dhe nga teknologjitë digjitale kompjuterike, të cilat krijojnë një botë të realitetit virtual.

Në rastet kur përdorimi i efekteve speciale është esencial dhe i përshtatet më së miri qëllimit të programit, përdorimi i tyre duhet të bëhet i qartë.

9.8 **Përbërja e pamjeve**

Tipari kryesor i komunikimit televiziv është pamja, si portret i dimensioneve kohore dhe hapësinore të ngjarjes apo veprimit.

Për shkak të fuqisë dominante sugjестive, fotografitë janë faktor vendimtar në krijimin e identifikimit racional dhe emocional, përmes krijimit të përshtypjeve, gjykimeve dhe mendimeve mbi materialin e incizuar dhe të emetuar. Në përgjithësi, janë dy qasje dominuese të kamerave, ajo subjektive dhe personale (e përdorur në programe fiktive) dhe ajo objektive dhe raportuese (e përdorur në programe faktike). Një qasje e caktuar subjektive në përgjithësi nuk është me vend në programet faktike.

Pamjet ose fotografitë në programet faktike bëhen për të paraqitur ngjarjen apo veprimin objektivisht. Kjo duhet t'i ofrojë shikuesit shansën për të fituar përshtypje të plotë të asaj që po zhvillohet dhe ndodhë. Elementi i vetëm fiktiv i pranueshëm është kohëzgjatja, kur kohëzgjatja reale e ngjarjes përshtatet duke prerë dhe redaktuar për kohëzgjatje të caktuar. Transmetimet direkte të ngjarjeve apo veprimeve bëjnë përjashtim.

Aparatet vizuale mundësojnë paraqitje fallse, të qëllimta ose të paqëllimta të ngjarjeve, rrethanave ose personaliteteve. Prandaj, duhet që t'i konsiderojmë me kujdes këndet e kamerës, ndryshimet post-prodhuese si dhe ndryshimet e përmbajtjes, pas aplikimit të mjeteve teknike. Aplikimi i procedurave të tilla mund të rezultojë në portretizim të shtrembëruar të realitetit, duke i imponuar auditorit vështrime të njëanshme.

9.8.1 **Incizimi, zgjedhja e formave dhe e këndeve**

Mesazhi dhe portretizimi i objektit ose personalitetit mund të modifikohet shumë me përdorimin e formave dhe këndeve të kamerës. Prandaj, në programet faktike duhet të përmbahemi nga përdorimi i këndeve të larta ose të poshtme të kamerës, kur portretizojmë personalitete, posaçërisht figura politike.

9.8.1.1 Këndi i ulët i kamerës

Këndi i ulët i kamerës u ofron shikuesve ngritje të pozitës së

personalitetit të portretizuar, përdersisa këndi i lartë i kamerës ka efekt të kundërt.

9.8.1.2 Afrimi dhe largimi

Afrimi dhe largimi kanë efekt të veçantë psikologjik dhe bartin implikime të caktuara. Programet faktike duhet t'i shmangen përdorimit të tyre, nëse nuk shërbejnë për ndonjë qëllim tjetër, më parë sesa të theksojnë së tepërmi tiparet dhe reaksionet e personalitetit.

9.8.1.3 Këndet dhe teknikat e kamerave

Këndet dhe teknikat e kamerave që zbulojnë jetën private dhe reagimet e individit të portretizuar, ose detajet intime, mund të aplikohen vetëm pas aprovimit paraprak të individit të portretizuar.

9.8.2 Redaktimi

Redaktimi i materialit të incizuar është teknikë esenciale dhe legjitime e gazetarisë, përderisa me përsëritjen e sekuencave ose shtimin e skenave të trilluara, nuk e shtrembëron reflektimin objektiv të ngjarjeve dhe veprimeve.

9.8.3 Përdorimi i teknologjisë kompjuterike

Përdorimi i teknikave të filmit vizatimor dhe efekteve speciale mund të dëmtojë vërtetësinë dhe besueshmërinë e materialit të incizuar. Në programet faktike duhet t'u shmangemi përdorimit të efekteve, siç janë ngurtësimi, lëvizja e ngadalshme, ekspozimi i dyfishtë ose efekte të tjera, që modifikojnë emetimin, nëse ato nuk aplikohen me qëllim të bartjes së më shumë informacioneve mbi ngjarje, zhvillime apo personalitete.

9.9 Rikonstruktimi dhe simulimi i ngjarjes

Çdo rikonstruktim apo simulim duhet t'i përshtatet sa më shumë ngjarjes e cila portretizohet.

Rikonstruktimi apo simulimi mund të jetë mjeti më efektiv në bartjen e llojit të caktuar të informacionit, siç është hulumtimi i gjithësisë, ose ngjarjet rreth ndonjë aksidenti. Nëse një ngjarje apo pjesë e saj është e rikonstruktuar ose simuluar gjatë programit, kjo duhet të bëhet e qartë për auditorin me mjete audio-vizuele.

9.10. Materiali arkivor

9.10.1 Etiketimi i materialit arkivor

Materiali arkivor i përdorur për ilustrimin e ngjarjeve ose çështjeve

tematike duhet të jetë i shenjuar qartë. Materiali arkivor nuk duhet përdorur për të ilustruar ndonjë ngjarje në atë mënyrë që shikuesit do t'i bëjë të besojnë se ajo ngjarje po ndodhë aktualisht.

9.10.2 Keqpërdorimi i materialit arkivor

Përdorimi i materialit arkivor duhet të tregohet qartë nëse kjo nuk është e dukshme nga konteksti i raportit, posaçërisht në lajme dhe në programet aktuale, ku materialin arkivor duhet të etiketohet si "material arkivor", bashkë me datën kur është incizuar.

Nuk duhet të përdorim materialin arkivor për të ilustruar ngjarjet në atë mënyrë që do të dezorientonte audiencën.

- a) Materiali arkivor i një ngjarjeje nuk duhet të përdoret për të ilustruar një ngjarje tjetër, në atë mënyrë që shikuesit t'i bëjë të besojnë se ajo ngjarje po ndodhë aktualisht.
- b) Portretizimet e dramatizuara ose rikonstruktivet nuk duhet të prezentohen si material dokumentar. Kur përdorim një skenë drame, si mënyrë e rrëfimit të ngjarjes në film dokumentar, për shkak të mungesës së materialit autentik, kjo duhet t'i bëhet e qartë auditorit.
- c) Një ngjarje mund të rikonstruktivet me qëllimin kryesor për të bartur informacionin faktik për shkak të mungesës së materialit autentik dhe ajo duhet të jetë e sinjalizuar qartë për auditorin. Publiku nuk duhet të ketë ndonjë dyshim se ku ka filluar dhe ku ka mbaruar rikonstruktivi.
- d) Përsëritja konstante e materialit të njëjtë arkivor për të ilustruar tema të ndryshme të paraqitura në lajme ose programe aktuale, mund të jetë corientuese, posaçërisht kur përfshin edhe fotografi të njerëzve të identifikueshëm.

9.11 Materiali arkivor që portretizon krimin

Duhet të kemi kujdes në përsëritjen e materialit arkivor që ka të bëjë me krimet dhe viktimat. Për çdo përdorim të materialit të tillë duhet vendim i vecantë, që kërkon gjykim dhe shije.

- a) nuk duhet përdorur materialin arkivor të një krimi të identifikuar për të ilustruar krimin tjetër;
- b) shumë rrallë mund të jetë i përshtatshëm përdorimi i pamjeve të vendit të krimit për të vlerësuar paraprakisht hetimin apo gjykimin e ardhshëm;
- c) kur zgjedhim materialin arkivor ilustrues, duhet t'i shmangemi përdorimit të pavëmendshëm dhe të shpeshtë të materialit racial, nacional, religjioz, seksual si dhe stereotipet e tjera.

9.12 Përzierja e aktualitetit dhe dramatizimit

Programet gazetareske në parim nuk duhet të jenë një përzierje e aktualitetit (paraqitje audio-vizuele e ngjarjeve aktuale dhe njerëzve të vërtetë) me portretizim dramatik të ngjarjeve dhe figurave të vërteta historike.

Publiku duhet të jetë në gjendje të gjykojë natyrën e informacionit të marrë. Përzierja e formave paraqet një gjykim më të vështirë për auditorin, sepse mund të bëjë që një hipotezë të duket reale.

Nëse shfaqet situata kur një përzierje e tillë e formave është metoda më adekuate për të bartur informacionin e duhur, pjesa e dramatizuar duhet të identifikohet qartë.

9.13 Satira

Satira nuk duhet të përdoret në programet informative, me përjashtim të përdorimit në mënyrë të drejtë me qëllim të vetëm të ekzaminimit serioz të çështjeve të rëndësishme. Kur ajo përdoret, ka efekt dykuptimor dhe përdorimi i saj në programe informative mund të shkaktojë konfuzion tek auditori lidhur me natyrën dhe qëllimin e programit. Pjesët satirike duhet të paraqiten në atë mënyrë që të dallohen nga informacioni origjinal, opinionet, pikëpamjet dhe informacionet e paraqitura nga këndi humoristik duhet të dallohen lehtë nga audiori.

10 RESPEKTIMI I VLERAVE TË DËGJUESVE DHE SHIKUESVE

10.1 Shija e mirë

Programet e RTK-së duhet të jenë të shijes së mirë, kjo do të thotë se ato duhet të respektojnë dhe të paraqesin vlera të pranuarra shoqërore kundruall çështjeve të tilla, si vulgariteti, fyerjes, apo sjelljeve seksuale.

Auditori i programit informativ përbëhet nga grupe të ndryshme, me pikëpamje të ndryshme për shijen e mirë dhe ato dallojnë qenësisht midis tyre. Transmetuesi nuk mund të presë të ketë lirinë e plotë të shprehjes së fjalorit ose pamjeve vizuale, ashtu sic i ka botuesi i librit, teatri apo filmi, lexuesit dhe shikuesit e të cilëve zgjedhin në mënyrë të vetëdijshme, atë që ata lexojnë ose shohin.

Sido që të jetë, do të ketë raste kur në pasqyrimin e realitetit nuk do të ishte me vend të cungohet përdorimi i një gjuhe të caktuar, apo paraqitja e dhunës apo seksualitetit, që normalisht do të ishte evituar. Po të vepronim kështu do t'i mohonim auditorit të RTK-së qasjen në ngjarje të caktuara, të cilat mund të kontribuojnë materialisht në të kuptuarit e botës në të cilën jetojnë.

10.2 Raportimi mbi çështjet shëndetësore

Programet e RTK-së e respektojnë si parim të përgjithshëm betimin e Hipokratit, i cili kërkon që të mos bëhet asgjë që mund të dëmtojë shëndetin e pacientit. Prandaj, raportimi mbi çështjet shëndetësore duhet të respektojë këto parime:

Informacionet dhe programet e emetuara nuk duhet që më sugjestionet e tyre të rrezikojnë shëndetin e dëgjuesve dhe shikuesve. Para emetimit, të gjitha faktet me ndikim potencial në shëndetin e njerëzve duhet të kontrollohen nga ekspertë mjekësor, edhe në qoftë se kjo mund të rezultojë në vonimin e programit.

Lajmet dhe programet e tjera nuk duhet të krijojnë shpresa të rrejshme dhe pritje se ndonjë "ilaç çudibërës" do të zbulohet së shpejti.

Për shkak të konfliktit të interesave, duhet t'u shmangemi reklamave ekonomike të barnave nga prodhues individualë.

Ne mbështesim fuqimisht parimin e besueshmërisë së të dhënave të pacientit, si dhe të historisë së tyre mjekësore. Ne nuk duhet, në asnjë mënyrë të lëndojmë ndjenjat e pacientit apo dinjitetin njerëzor. Ne duhet të jemi plotësisht të vetëdijshëm se emetimi mund të

ndërrojë përjetësisht jetën e tyre.

Ne duhet të mendojmë për mënyrat e minimizimit të pikëllimit ose shqetësimit të individëve, posaçërisht të fëmijëve dhe të sëmurëve rëndë.

Ne duhet të respektojmë intimitetin e të dashurve të pacientit dhe të familjarëve të tjerë.

Ne duhet të mbrojmë intimitetin e njerëzve, edhe atëherë kur mbulojmë fatkeqësitë natyrore. Përcjellja e të plagosurve, të sëmurëve ose personave të prekur në këto raste duhet të shmanget, nëse kjo është e mundur.

Në rast dyshimi, duhet t'i shmangemi raportimit mbi çështjet shëndetësore.

10.3 Seksi

Skenat e drejtpërdrejta të lakuriqësisë ose erotikës janë të pranueshme vetëm nëse është e qartë se ato janë esenciale për informacionin e dhënë në program dhe ai informacion vetëvetiu është i rëndësishëm për justifikimin e emetimit. Këto skena asnjëherë nuk duhet të cekën ose të përdoren vetëm për të shokuar ose për senzacion.

10.4 Pikëllimi dhe vuajtja

Skenat e vuajtjes duhet të paraqiten vetëm kur është e nevojshme për kuptimin e informacionit të rëndësishëm për publikun. Në paraqitjen e anëve pikëlluese kërkohet diskrecion dhe, nëse përdoren, nuk duhet të zgjasin pa nevojë. Pikëllimi privat ndonjëherë mund të paraqesë qëllim legjitim të programit, por nuk duhet të shfrytëzohet për efekte senzacionale dhe intimiteti personal duhet të respektohet.

10.5 Dhuna

Dhuna nuk duhet të paraqitet në programet informative të RTK-së. Është politikë e jona që të mos paraqesim dhunën, përpos kur përshtatimi i saj është fakt esencial i realitetit.

Paraqitja e skenave apo ngjarjeve të dhunës duhet të jetë një reflektim i saktë i realitetit dhe i përshtatur për kontekstin e programit.

10.6 Shpalljet paralajmëruese

Nëse programi përmban material, i cili mund të paraqes pengesë për disa grupe të publikut (posaçërisht fëmijët) për shkak të skenave të dhunës, sjelljes seksuale, gjuhës, shpalljet paralajmëruese duhet të përdoren para ose gjatë programit.

10.7 Ndërprerjet e programit

RTK-ja mund të informojë auditorin lidhur me ngjarjet e jashtëzakonshme, pa pritur për emisionin e ardhshëm të lajmeve. Televizioni mund të emetojë informacionin me titra, pa e ndërprerë programin që është duke u emetuar, përderisa radio është e kufizuar për të bërë këtë. Ndërprerjet e tilla duhet të sinjalizohen qartë dhe duhet të bëhen vetëm pas një trajtimi të hollësishëm redaktorial lidhur me përshtatshmërinë e shenjës, "lajmet e fundit", në mënyrë që të shmangët shqetësimi dhe ndërprerja e panevojshme e programit të rregullt. Vendimi për të ndërprerë programin në mënyrë që të emetohen lajmet urgjente merret nga redaktori përgjegjës, bashkë me kryeredaktorin.

10.8 Tiparet e veçanta të radios

Radio është medium tipik, i cili përfshin auditor më të gjerë. Përveç informacioneve të përgjithshme, programet e radios ofrojnë informacione shërbimesh që i dalin në ndihmë klientit. Këtu hyjnë informacionet mbi trafikun, informacionet mbi ngjarjet e veçanta, parashikimin e motit dhe informacione të tjera që emetohen në bazat e informacioneve të vërtetuara, në mënyrë që të parandalohet keqpërdorimi dhe manipulimi i bartur tek dëgjuesit.

Programet e radios gjithashtu emetojnë shpallje emergjente, kur radioja si medium mbështet kërkimin e ndonjë personi, zakonisht ndonjë familjari të ngushtë të personit të vdekur. Certifikata zyrtare e vdekjes duhet të lëshohet para emetimit të thirrjes.

11 PROGRAMET ME INTERES TË VEÇANTË

11.1 Programet për pakicat kombëtare

Përpos kohës së paraparë me ligj për programet në gjuhën e pakicave kombëtare dhe për pakicat kombëtare, programet e RTK-së i kushtojnë kujdes të posaçëm jetës dhe gjendjes së pakicave kombëtare në Kosovë (Serbe, Boshnjake, Turke dhe Rome) si dhe pakicave të tjera kombëtare që jetojnë këtu.

Programet janë të hapura për çështjet që ata i preokupojnë. Si institucion publik, RTK-ja duhet të respektojë të drejtat e tyre dhe të kontribuojë në zhvillimin e tyre bazuar në barabartësi. Mbulimi i çështjeve që kanë të bëjnë me komunitetet dhe grupet etnike duhet të jetë një prej fokusimeve kryesore të lajmeve qendrore dhe programeve të tjera që trajtojnë aktualitetin në programet e RTK-së.

11.2 Kosovarët që jetojnë jashtë vendit

Kosovarët që jetojnë jashtë vendit janë ndër preokupimet kryesore programore të RTK-së. Gjendja dhe puna e tyre reflektohet në të gjitha programet e RTK-së. **Programet e posaçme duhet të mbulojnë nevojat e tyre specifike dhe ruajnë kontaktet me ta, posaçërisht përgjatë emitimit satelitor të RTK-së.**

11.3 Programet religjioze

Përmbajtja religjioze është pjesë përbërëse e programeve të RTK-së. Redaktorët e RTK-së duhet të sigurojnë një prezantim të balancuar të të gjitha komuniteteve fetare pa diskriminim. Në mënyrë që të informohet publiku për jetën religjioze të komuniteteve të ndryshme që jetojnë në Kosovë dhe për të promovuar tolerancë mes tyre, RTK-ja mund të ftoj para ngjarjeve të mëdha fetare (Ramazani, Bajrami, Krishtlindjet Katolike e Ortodokse dhe Pashkët) në përputhshmëri me standardet ekzistuese kulturore evropiane, liderët e komuniteteve të ndryshme religjioze në Kosovë, për t'i dhënë mesazhe të shkurtëra religjioze publikut.

Këto mesazhe me përmbajtje strikte religjioze duhet të emitohen jashta edicioneve të rregullta të lajmeve.

Gazetarët gjatë punës së tyre nganjëherë mund të paraqiten në programe fetare dhe e njëjta gjë vlen edhe për gazetarët që punojnë në programet fetare, në të dy rastet me aprovim paraprak të kryeredaktorit.

11.4 Paraqitja e religjionit dhe grupeve religjioze

Njerëzit dhe shtetet nuk duhet të definohen në bazë të religjionit, me përjashtim kur kjo është e duhur. Fraksionet e caktuara religjioze nuk duhet të paraqiten, sikur kemi të bëjmë me besimin e tyre në tërësi. Fjalët e tilla, si "fundamentalist", "militant" dhe "islamist" duhet përdorur me kujdes të madh. Një përshkrim që mund të jetë korrekt për një grup mund të mos jetë i saktë për grupe të tjera të ngjashme. Kisha nuk mund të përdoret si sinonim për kishën katolike apo kishën ortodokse. Shumë nga komunitetet religjioze në Kosovë e përdorin termin kishë; prandaj, programet duhet ta cekin qartë se cilës kishë i referohen: Romano-katolike, protestane, ortodokse. Në rastet kur programi fokusohet vetëm në një kishë dhe kjo bëhet e qartë për dëgjuesit dhe lexuesit nga konteksti, ne mund të përdorim fjalën "kisha", dhe kjo vlen për çdo komunitet religjioz të krishterë.

11.5 Shërbimet ndërkombëtare

RTK-ja në kornizën e programeve të rregullta mund të emetojë edhe programe në gjuhë të huaja që i dedikohen auditorit ndërkombëtar.

Ky është një prodhim i veçantë, duke pasur parasysh praktikën dhe traditën që synon ai.

12 PARAQITJA E GRUPEVE TË POSAÇME TË SHOQËRISË

RTK-ja ka për detyrë t'u shërbejë të gjitha pjesëve dhe grupeve të shoqërisë. Gjatë shmangies së stereotipeve dhe paraqitjes të gjithë spektrit të roleve (funksioneve), duhet të kemi kujdes nga rreziku i përshkrimit të një shoqërie që nuk ekziston. Aty ku ka paragjykime dhe situata të pafavorshme ne duhet t'i raportojmë dhe pasqyrojmë ato në programet tona, por ne nuk duhet të bëjmë asgjë që t'i përjetësojmë ato.

Të gjitha grupet kanë disa shqetësime të përbashkëta, sepse ndihen se janë prezentuar në mënyrë joadekuate në programe. Duke pasur parasysh rrethanat e posaçme shoqërore, etnike e politike në Kosovë, Programet e RTK-së nuk duhet në çfarëdo rrethana të karakterizojnë asnjë grup etnik si kriminelë apo të përdorin çfarëdo forme të shprehurit urrejtje-nxitës.

Femrat nuk duhet të trajtohen si shtëpiake, njerëzit me aftësi të kufizuara si viktima homoseksualët si të padobishëm, pleqët si të paaftë apo që njerëzit e profesioneve të caktuara, zanateve, si figura të pashmangshme për humor.

Njerëzit duhet të paraqiten në llojllojshmërinë e roleve që kryejnë të cilat reflektojnë realitetin.

12.1 Paraqitja e femrave

Përkundër ligjeve dhe qëndrimeve që ndryshojnë vazhdimisht, femrat vazhdojnë të jenë të diskriminuara në disa aspekte. Prandaj është jo me vend që të krijohet përshtypja se disa aktivitete të caktuara janë të rezervuara vetëm për njërin gjini. Meqenëse pothuajse për të gjitha profesionet ka terme alternative që nuk janë gjinore, duhet të përdorim këtë terminologji jogjinore.

12.2 Paraqitja e njerëzve të paaftë

Programet mund të jenë sensitive për sa u përket të drejtave dhe dinjitetit të personave me aftësi të kufizuara, pa humbur fuqinë redaktuese. Njerëzit me aftësi të kufizuara nuk duhet të merren në mbrojtje dhe të karakterizohen as si "heronjë të guximshëm" e as si "viktima për t'u ardhur keq". Njerëzit me invaliditet duhet të paraqiten mirë në programet tona dhe publiku duhet të informohet në mënyrë të saktë dhe të paanshme, si dhe të sensibilizohet për shqetësimet dhe çështjet e tyre.

Duhet pasur kujdes të veçantë që terminologjia e përdorur të jetë

moderne dhe e pranuar nga ekspertët dhe të shmangët përdorimi i termeve të vjetëruara dhe ofenduese të gjuhës së përditshme.

Termet e përshtashme janë, “me aftësi të kufizuara” ose “person me aftësi të kufizuara”. Për më tepër, mund të përdorim termin “i shurdhët” dhe “i shurdhër” (“shurdhmemec” nuk është më term i pranueshëm), “i verbër” ose “me të pamur të çrregulluar”, “njerëz me vështirësi lëvizjeje” (kur flasim për “njerëz në karrocë invalidësh” ose “personat që shrytëzojnë karrocë të invalidëve”), “persona me paaftësi intelektuale”, etj.

Ne përmbahemi nga përdorimi i termeve të tillë, si “i hendikepuar mentalisht”, “defekt”, “i hendikepuar”, “sakat”, “i retarduar”, etj. Kur u referohemi njerëzve që përdorin karrocë invalidësh, ne nuk përdorim termin “i izoluar në karrocë” ose “i lidhur për karrocë”.

Para intervistimeve dhe programeve të tjera, redaktorët dhe nikoqirët duhet të konsultohen me personat e paaftë për temën dhe të pyeten se a e pranojnë ata terminologjinë e propozuar. Njerëzit me aftësi të kufizuara, zakonisht nuk përpiqen të fshehin këtë dhe mund të flasin për të hapur dhe konkretisht. Ne duhet të respektojmë dëshirën e disa grupeve të njerëzve me aftësi të kufizuara që përdorin terminologji tjetër nga ajo e grupeve të tjera.

Kur u referohemi fëmijëve me aftësi të kufizuara, ne flasim për “fëmijë me nevoja të veçanta”. Në të njëjtin kontekst ne shfrytëzojmë shprehjen “fëmijët e shurdhër dhe me vështirësi dëgjimi”, “fëmijët e verbër dhe me të pamur të çrregulluar”, “fëmijë me lëvizje të vështirësuar”, “fëmijë me çrregullim të sjelljes dhe personalitetit”, “fëmijë me çrregullim të të folurit”, etj.

Njerëzit me aftësi të kufizuara duhet të kenë qasje në godinat dhe studiot ku prodhohet programi dhe duhet të prezentohen në program në mënyrën që ata dëshirojnë.

Menaxhmenti i RTK-së duhet ta marrë këtë (provision?) në konsiderim me kujdes të veçantë.

12.3 Paraqitja e pakicave seksuale

Homoseksualët në veçanti janë objekt i stereotipeve ofenduese dhe të pamenduara. Këto stereotipe madje mund të fuqizohen nëse programet lejojnë ofendime dhe përgjithësime, kurse qasja e paraqitjes së vërtetë mund të ndihmojë në ndryshimin e këtyre stereotipeve. Në paraqitjen e seksualitetit, ne duhet t’u shmangemi thjeshtëzimeve, stereotipeve dhe gjykimeve personale. Marrëdhëniet homoseksuale duhet të paraqiten me saktësi dhe paanësi. Keni parasysh efektin e gjuhës së përdorur. Nuk duhet ngatërruar homoseksualizmin me transvestizmin dhe transseksualizmin.

12.4 Paraqitja e njerëzve të moshuar

Programet e RTK-së i kushtojnë një vëmendje të posaçme paraqitjes së të moshuarve; qëllimi është që të krijohet një model i përshtatshëm i qëndrimit të publikut ndaj të moshuarve. Kjo përfshin programet që synojnë moshat e vjetra sikurse edhe programet ku ato participojnë si garues ose artistë.

Një numër gjithnjë e më i madh i njerëzve të vjetër bëjnë jetë energjike dhe të plotë. Imazhet që i paraqesin ata si njerëz që jetojnë në margjina, të varur, fizikisht të dobët dhe pasivë, nuk pasqyrojnë realitetin, prandaj kjo grup-moshë duhet të paraqitet në mënyrë realiste.

13 FËMIJËT DHE TË MITURIT NË PROGRAMET E RTK-SË

Fëmijët mund të paraqiten në programet e RTK-së në shumë mënyra: si aktorë, përmes intervistimeve, pjesëmarrjes në program ose nganjëherë edhe si prodhues të programeve. Pjesëmarrja e fëmijëve në programe shpesh kërkon kujdes të madh: mund të jetë e vështirë për prodhuesit e programeve që të arrijnë të balancojnë në mes të ndeshjes së interesave të fëmijëve, të prindërve dhe të auditorit si tërësi.

Ne gjithashtu duhet të respektojmë interesin e fëmijëve, të cilët janë shikues dhe dëgjues së programeve të RTK-së, qoftë kur programet u dedikohen atyre qoftë një auditori më të gjerë.

Shpesh do të jetë e udhës që të kërkohet pëlqimi i prindërve ose mbrojtësve ligjorë përpara se të intervistohet ose të përfshihet në mënyrë të tjera një fëmijë në program, sepse sa më i vogël ose i prekshëm që është fëmiju dhe sa më e ndjeshme që është tema që trajtohet, aq më i rëndësishëm bëhet pëlqimi i prindërve. Nëse fëmijët duhet të marrin pjesë në një program, i cili realizohet gjatë kohës që ata janë në shkollë, normalisht se është e nevojshme të kërkohet pëlqimi i shkollës.

Nëse prindërit refuzojnë, kjo duhet t'i referohet kryeredaktorit para se të merret çfarëdo vendimi për të vazhduar më tej.

Në rast të dramës që përfshin interpretimin e fëmijëve dhe nëse fëmiju kërkohet gjatë orëve të shkollës, atëherë kërkohet pëlqimi i shkollës.

Gazetarët dhe prodhuesit e tjerë të programeve duhet të shqyrtojnë me kujdes ndikimin e programeve tek fëmijët, përfshirë ndikimin që ka vetë mënyra e krijimit të programit, si dhe ndikimi i mundshëm që ai mund ta ketë gjatë emetimit.

Prodhuesit e programeve duhet që të konsultojnë profesionistët dhe ekspertët kur punojnë me fëmijët.

Kur trajtojnë tema të rrezikshme ose aktivitet të paligjshëm në mes fëmijëve, siç është konsumimi i drogës dhe prostitucioni, shpeshherë është e këshillueshme që ekipet e programit të shoqërohen nga ekspertë të pavarur gjatë gjithë kohës së kontaktit të tyre me fëmijët. Në programet faktike që bëjnë fjalë për fëmijët e përfshirë në aktivitet ilegal ose sjellje anti-sociale, identifikimi i tyre mund të krijojë një problem të rëndë etik. Mund të jetë në interes të publikut që këta fëmijë të identifikohen, por interesi afatgjatë i fëmijës mund të kërkojë që ata të mbesin anonim. Prodhuesit e programit duhet t'i drejtohen prodhuesit më të vjetër kur janë në dilemë për atë se si të veprojnë. Pëlqimi i prindërve mund të mos jetë i mjaftueshëm për ta identifikuar fëmijën, nëse e ardhmja afatgjate e tij do të ishte më e mirë sikur ai të mbetet anonim.

Kur incizojmë veprime asociale ose kriminale me synim që të tregojmë praktikën e këtyre veprimeve dhe jo individët, rregulli i përgjithshëm është se në këtë rast fëmijët nuk do të identifikohen.

Intervistimi i fëmijëve kërkon një kujdes të veçantë. Fëmijët lehtë mund të ndikohen gjatë pyetjeve dhe mund të bëhen sugjestivë. Në veçanti, fëmijët e vegjël mund të kenë vështirësi në dallimin mes realitetit dhe fantazisë. Prodhuesit e programit duhet të jenë të kujdesshëm të mos e nxisin fëmijën por ta lënë atë të flasë vetë. Fëmijët nuk bën të pengohen të flasin, ose të merren në mbrojtje.

Asnjë e dhënë që gjatë procedurës gjyqësore çon në identifikim e një dëshmitari, të akuzuari ose ndonjë pale tjetër, që është nën moshën 18-vjeçare nuk bën të publikohet. Kufizimet përfshijnë edhe emërimin e shkollave dhe adresave. Asnjë fotografi e personit nën moshën 18-vjeçare nuk bën të emetohet. Një fëmijë i përfshirë në procedura gjyqësore si i pandehur (i njohur si i "akuzuar), qoftë ai viktimë ose dëshmitar nuk guxon të identifikohet.

E njëjta gjë vlen edhe për procesin e kujdestarisë ndaj një fëmije, adoptimit, përkujdesjes dhe problemeve të ngjashme.

Fëmijët, viktimë të dhunës seksuale, gjithashtu nuk bën të identifikohen.

Zakonisht gjyqi refuzon emetimin e të dhënave të hollësishme të procedurave që zhvillohen për një çështje private. Kjo përfshin edhe procedurat për kujdestari, tutelë ose adoptim të një foshnje. Në rastet e kujdestarisë nuk është e ndaluar që të raportohet vendimi i gjyqit ose një përmbledhje e saktë e tij, me përjashtim të rastit kur gjyqi nuk e ndalon këtë në mënyrë eksplicite.

RTK ka të drejtën për të mos emituar asnjë video material me fëmijët (psh: fëmijë lakuriq apo në situata poshtëruese) i cili konsiderohet si i padenjë apo poshtërues.

14 NDËRHYRJET

14.1 Kërkesë ndaj RTK-së që të ndalojë materialin

Pasi të incizohet materiali në përputhje me politikën gazetareske, ai mund të përdoret për emetim me kusht që të mos ndërhyjë asnjë faktor që do t'ia kalonte nevojave programore dhe që asnjë kontratë tjetër nuk është bërë në kohën e incizimit.

Duhet bërë një vlerësim i mirë, për të balancuar mes arsyeve për kërkesën për ndalimin e materialit kundrejt kërkesave programore. Këto arsye mund të përfshijnë kalimin e një intervali kohor, gjatë së cilit konteksti mund të ketë ndryshuar.

Nëse bëhen kërkesa për ndalimin e materialit për emetim, pasi që ai është incizuar me vullnet, regjisorët dhe mbikëqyrësit duhet të rishikojnë natyrën e kontratës e cila është bërë në kohën e incizimit. Nëse përgatitja e materialit për përdorim është bërë në përputhje me kontratën dhe asnjë faktor tjetër nuk ndërhyr, kërkesa për ndalimin e materialit nga emetimi nuk plotësohet.

Gjithmonë duhet bërë përpjekje për të sqaruar pozitën e RTK-së.

14.2 Vetoja në materialin programor nga pjesëmarrësit e ftuar në program

Pjesëmarrësit në program nuk u jepet e drejta që të vendosin veto në asnjë pjesë të programit.

Përgjegjësia për materialin programor nuk bën të transferohet prej RTK-së, që është përgjegjësi i vetëm për atë që ajo emeton dhe si garancë për programet e veta e ka politikën e saj gazetareske.

Pjesëmarrësit e ftuar do të kenë një këndvështrim të posaçëm të temave të programit dhe rolin e tyre në këto temë. RTK-ja nuk duhet t'i ekspozohet presionit nga një ose më shumë pjesëmarrës. Kjo mund të ketë si pasojë padrejtësinë dhe humbjen e balancit.

14.3 Censura

Duke pasur parasysh lirinë e shtypit, çdo formë e censurës është e paligjshme dhe jo etike. Redaktorët dhe gazetarët e RTK-së nuk bën të dorëzohen para asnjë forme të presionit, direkt ose indirekt, që do të censuronte programet e tyre. Këto programe nuk duhet të kalojnë në forma të vetëcensurës konformiste, meqenëse konformizmi nuk është në përputhje me gazetarinë e pavarur. Kujdesi i veçantë që duhet pasur gjatë emetimit të informatave jozyrtare nga Interneti nuk mund të krahasohet me censurën. Aty ku materialet programore janë prekur

si rezultat i nënshtrimit, autoritetet, redaktorët dhe gazetarët ose udhëheqja e programit duhet ta bëjë atë publike gjatë emetimit. Kur kufizimet e tilla kanë të bëjnë me gazetarët që raportojnë nga jashtë, kjo duhet t'i bëhet e ditur publikut në kohën e emetimit.

15 E DREJTA PËR KORREKTIM

RTK-ja nuk do të hezitojë të pranojë ndonjë gabim në materialet e veta kur ajo konstatohet se është bërë. Të bësh të kundërtën, ose të mbrosh një program që ka një shije të dobët ose etikë të papranueshme, ose që përmban gabime, në mënyrë të pashmangshme do të çojë në humbjen e besueshmërisë.

Gabimet në fakte duhet të korrigjohen qartë dhe shpejt në mënyrë që të ruhen parimet e saktësisë dhe ndershmërisë. Kryeredaktori i lajmeve dhe programeve që trajtojnë aktualitete duhet të konsultohen për të përcaktuar natyrën dhe kohën e korrigjimeve. Korrigjimi mund t'u referohet fakteve të cituara gabimisht dhe kohëzgjatja e tij nuk duhet të tejkalojë në masë të madhe kohëzgjatjen e emetimit të gabuar.

Korrigjimi, në disa rrethana, mund të përfshijë reagimin dhe kërkim falje dhe mund të ketë pasoja ligjore.

16 OMBUDSMANI /MBROJTËSI E STANDARDEVE PROFESIONALE DHE PARIMEVE TË ETIKËS GAZETARESKE

Mbrojtësi i standardeve profesionale dhe parimeve të etikës gazetareske në programet e RTK-së mbikqyrë implementimin e standardeve profesionale dhe parimet e etikës gazetareske, ashtu siç është definuar me këtë dokument. Për më tepër, mbron interesat e paguesve të parapagimit, sikurse edhe ato të gazetarëve dhe prodhuesve të tjerë të programeve në radio dhe television, kundër ankesave dhe kritikave të pabaza dhe kundër masave të pabazuara që mund t'i ndër marrin redaktorët.

Në përputhje me ligjet që drejtojnë RTK-në, dëgjuesit dhe shikuesit në

fillim duhet t'u drejtohen kryeredaktorëve të programeve të radio dhe televizioni me ankesat, propozimet dhe këshillat e tyre. Nëse nuk janë të kënaqur me përgjigjen ose veprimin e tyre, ata mund ta përcjellin shqetësimin e tyre më tej, tek mbrojtësi i standardeve profesionale dhe parimeve etike.

Mbrojtësi vepron si regjistruer i ankesave, iniciativave dhe pyetjeve të shikuesve dhe dëgjuesve, si dhe të punëtorëve të RTK-së; përpos kësaj, ai ose ajo mund ta fillojë seancën për iniciativën e tij/saj.

Mbrojtësi, në fazën e parë të çdo seance duhet të përcaktojë se a është shkelur ndonjë standard profesional ose parim etik i RTK-së dhe, nëse po, atëherë cili. Mbrojtësi pastaj ia raporton konkluzionet individit ose organizatës/institucionit që ka ngritur ankesë, iniciativë ose ka parashtruar pyetje, si dhe drejtorëve të programeve radiotelevizive dhe kryeredaktorëve të programeve që dyshohet se kanë bërë shkelje. Në rastet kur kur bëhet fjalë për një shkelje të supozuar të standardeve profesionale dhe parimeve etike, që është me një interes shumë të madh për publikun dhe për një auditor më të gjerë, pra është më shumë se vetëm një ankesë, atëherë është detyrë e mbrojtësit që t'i publikojë ato.

Mbrojtësi i standardeve profesionale dhe parimeve etike është një organ i Bordit të RTK-së dhe duhet t'i raportojë atij me rregull. Udhëheqja e programit duhet t'i ofrojë mbrojtësit mundësinë për të "publikuar" konkluzionet e tij në programet e veçanta të radios dhe televizionit.

Vendimet e mbrojtësit të standardeve profesionale dhe parimeve etike janë detyruese për të gjithë prodhuesit e programeve të RTK-së.

Statuti i RTK-së e definojnë detajisht se kush mund të zgjidhet mbrojtës i standardeve profesionale dhe parimeve etike të RTK-së, dhe cilat kushte duhet t'i plotësojnë kandidatët për mbrojtës. Metodrat dhe procedurat e institucionit të mbrojtësit të standardeve profesionale dhe parimeve etike definojnë nga Bordi i RTK-së.

17 REFERIMI I DOMOSDOSHËM

Të gjitha materialet e prodhuara nga RTK-ja çoftë në gjuhën shqipe apo në atë të komuniteteve duhet të jenë në dispozicion të të gjitha departamenteve dhe gazetarëve në pëputhshmëri me renditjen dhe planin e adoptuar programor. Parimi i njëjtë duhet të aplikohet poashtu për mjetet dhe pajisjet teknike me kujdes të veçantë ndaj programeve në

gjuhën e komuniteteve.

Të gjithë gazetarët dhe redaktorët pavarësisht nga departamenti apo programi në të cilin punojnë (në seksionin e gjuhës shqipe apo në atë të komuniteteve në RTK) duhet të trajtohen bazuar në barabartësi, pa çfarëdo lloj paragjykimi apo njëanshmërie lidhur me etnicitetin.

Gazetarët, redaktorët dhe prodhuesit e tjerë të RTK-së duhet t'i informojnë redaktorët më të lartë për punën e tyre dhe të konsultohen me ta për çështje të diskutueshme që mund të hasen në përgjigjen e gjerë të publikut.

Gazetarët duhet të respektojnë vendimet editoriale: në raste të mospajtuershmërisë në mes të gazetarit dhe redaktorit përgjegjës, gazetari duhet ta respektojë vendimin editorial por ka të drejtë që të kërkojë nga kryeredaktori ta vlerësojë vendimin e diskutueshëm (vendimin në fjalë) dhe të marrë masat gjegjëse.

Nëse mbulimi i çështjeve të tilla do të paraqiste një shkelje të standardeve dhe parimeve etike të RTK-së, vendimi përfundimtar se si duhet të veprojnë gazetarët dhe prodhuesit e tjerë të programeve merret nga kryeredaktori i programit të radios ose televizionit që duhet ta emetojë materialin në fjalë.

Përkundër parimeve të hierarkisë, redaktorët nuk janë të autorizuar të ndryshojnë, adaptojnë ose të shkurtojnë shumë materialin pa miratimin e gazetarit.

Gazetarët dhe prodhuesit e tjerë të programeve konsultohen dhe u referojnë redaktorëve më të vjetër, të cilët informojnë dhe konsultojnë redaktorët e programeve individuale, të cilët i referojnë kryeredaktorit. Kryeredaktori, redaktori i programit, redaktori i departamentit dhe redaktori i programeve individuale janë të obliguar t'i japin redaktorit të ri ose gazetarit mundësinë që të diskutojë çështjen ose të kërkojë konsultime.

Të punësuarit nuk lejohen të japin informata apo të bëhen burime jozyrtare të informacionit për cilindo medium të jashtëm, lidhur me çështjet të cilat konsiderohet të jenë të natyrës së brendshme të RTK-së.

Të punësuarit mund t'ia komunikojnë një informatë të tillë medimeve të tjera vetëm me autorizim eksplisit nga ana e Drejtorit Gjeneral të RTK-së.

18 NDIHMA LIGJORE PËR GAZETARËT DHE REDAKTORËT

Është përgjegjësi e RTK-së t'u ofrojë ndihmë dhe këshilla ligjore gazetarëve dhe redaktorëve, edhe nëse ata i kanë shkelur standardet profesionale dhe parimet etike, kanë bërë shkelje të ligjit ose të ndonjë rregulle tjetër të Kosovës apo të vendit prej ku ata raportojnë. RTK-ja do të bart shpenzimet e asistencës ligjore. Megjithatë, ka të drejtë t'ia mohojë asistencën ligjore të punësuarit i cili qëllimisht dhe në mënyrë evidente ka shkelur ligjin dhe parimet e parashtruara në këtë dokument.

Asistenca ligjore zbatohet me qëllim që të parandalohen rastet në të cilat mund të rrezikohen parimet e saktësisë, paanshmërisë dhe besueshmërisë së programeve të RTK-së, gjithashtu të mbrohen nga dëmi material ose financiar i shkaktuar si dhe dëmtimi i reputacionit të individëve ose i RTK-së si institucion.

Në mënyrë që t'i shmangët përshtypjes së animit në favor të punëtorëve të vet, menagjmenti i RTK-së është i obliguar të sigurojë asistencë ligjore nga ekspertë të pavarur, juristë të respektuar dhe avokatë në kushtet që do të lejojnë përgaditje me kohë, prodhime dhe emetime të pjesëve të programit. RTK-ja do t'i mbulojë shpenzimet e asistencës ligjore. Si do që të jetë, ka të drejtë të refuzojë ofrimin e asistencës ligjore për punëtorët, të cilët me paramendim dhe dukshëm i kanë shkelur parimet e përshkruara në këtë dokument.

19 REKLAMIMI, PROMOVIMI DHE SPONSORIZIMI NË PROGRAMETE RTK-së

19.1 Kriteri Etik i Reklamimit

Programet e RTK-së do të pranojnë të emetojnë vetëm reklamat që përputhen me ligjin dhe parimet e etikës:

Porosia e bartur në reklamë duhet të jetë e vërtetë. Emetimi i reklamave mashtruese është joetik dhe kundërligjor.

Çmimet e vendosura duhet të jenë korrekte dhe jomashtruese për klientin.

Reklamat nuk duhet të krahasojnë prodhimet e ndryshme.

Reklamata e mangëta dhe të përshtatshme për produktin ose shërbimin i cili mund të jetë mashtrues për konsumatorët, nuk duhet të emetohet.

Reklamata nuk duhet të jenë në kundërshtim me shijen e mirë, ndjenjat religjioze apo ndjenjat e tjera të shikuesve dhe dëgjuesve.

Reklamata që u dedikohen fëmijëve kërkojnë vëmendje të veçantë; ato nuk duhet të përmbajnë çfarëdo elementi, i cili do të rrezikonte shëndetin e tyre, sigurinë apo edukimin. Kriteret e njëjta aplikohen për reklamata, të cilat paraqesin fëmijët ose tregojnë shfrytëzimin e fëmijëve.

Emetimi i reklamave, të cilat nuk i përmbushin këto kritere do të refuzohet nga menaxhmenti i programit.

RTK-ja do të përpiqet që të mbështesë organizatat dhe projektet humanitare.

19.2 **Reklamimi dhe promovimi**

Programet e RTK-së do të emetojnë reklamata në pajtim me dispozitat e shkruara në statutet e RTK-së.

Emetimi i Reklamave mund të rregullohet vetëm nëpërmes Departamentit të Shërbimit të Marketingut të RTK-së apo agjencionit të autorizuar për marketing.

Përveç Departamentit të Shërbimit të Marketingut, asnjë departament tjetër nuk është i lejuar të vendosë reklamata në programet e RTK-së.

Departamenti i Shërbimit të Marketingut do të vlerësojë: kur të lëshojë reklama ekonomike në programet e saj, përputhshmërinë e përmbajtjes së tyre dhe aspektet teknike në bazë të kriterëve të Kodit të Reklamimit, rekomandimeve të Këshillit të Evropës, EGTA dhe konventave të tjera ndërkombëtare.

Emetimi i reklamës që përputhet me të gjitha kriteret mund të emetohet.

Departamenti i Shërbimit të Marketingut duhet të refuzojë emetimin e reklamave ekonomike në rastet kur:

- përmbajtja nuk është në përputhje me dispozitat ligjore;
- reklama nuk është në përputhje me parimet e programit të RTK-së;
- reklama nuk është në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi;
- përmbajtja ose paraqitja shkel konventat ndërkombëtare mbi mbrojtjen e fëmijut;
- reklama mundohet të nxis urgjentisht blerjen e produktit të reklamuar;
- reklama bart porosi që fyen ndonjë person juridik ose person

privat ose RTK-në;
përmbajta e reklamës (fjalët, muzika ose fotografia) ofendojnë dinjitetin njerëzor ose dinjitetin e një personi apo grupi.
Reklama bindë ose nxit shikuesit të veprojnë në atë mënyrë që do të rrezikonte shëndetin e tyre, sigurinë apo jetën e një personi apo grupi;
Reklamon sjellje që potencialisht e rrezikojnë ambientin;
Është në konflikt me normat dhe vlerat kulturore;
Abuzon ose fyen ndjenjat religjioze, ose bindjen partiake të një personi apo grupi;
Porosia propagandon jotolerancë religjioze, racore, në moshë, ose kombëtare;
Paraqet dhunë ose skena pornografike, në atë mënyrë që mund të kuptohen si kurajo për sjellje seksuale të paturpshme në mjedisin tonë kulturor;
Kur shpif, diskrediton ose fyen kompanitë, organizatat, shoqërinë, si dhe institucionet qeveritare dhe përfaqësuesit e tyre;
Reklama reklamon prodhim ose shërbim ilegal;
Reklama nuk është në gjuhët në të cilat RTK-ja transmeton program;
Klienti i cili e ka porositur reklamën nuk e ka të regjistruar biznesin të cilin e reklamon;
Reklammat për emetuesin i cili është në garë të drejtpërdrejtë me RTK-në;
Reklamon partinë e caktuar politike jashtë fushatës elektorale;
Klienti nuk u bindet kushteve të kontratës ose vepron kundër kushteve të biznesit të RTK-së;
Klienti ose një nga anëtarët e tij kanë obligime ndaj RTK-së;
RTK-ja është e përfshirë në procedura ligjore kundër klientit për shkak të obligimeve të papërmbushura;
Koha në program e parashikuar për reklamim është e mbushur;
Klienti nuk paraqet porosi të definuar qartë;
Materiali reklamues i inçizuar nuk përputhet me standardet teknike të RTK-së;
Reklama nuk është klasifikuar sa duhet;
Teksti i reklamës nuk është i korigjuar dhe në përputhshmëri me standardet gjuhësore të RTK-së;
Reklama bën përdorimin e paautorizuar të materialit arkivor të RTK-së;
Reklamon lidhje komerciale telefonike që ofrojnë shërbime seksuale ose atyre të tregimit të fatit.

Departamenti i Shërbimit të Marketingut është përgjegjës për

reklamimin dhe promovimin në Teletekst dhe në ueb-faqet e RTK-së.

Përgjegjësia për reklamat e emetuara në programet e RTK-së bie mbi drejtorin gjeneral të RTK-së ose përfaqësuesin e tij të autorizuar.

Klienti që porosit emetimin e reklamës është përgjegjës për autenticitetin e përmbajtjes.

RTK-ja nuk lejon reklamimin e fshehtë në programet e veta, duke përfshirë edhe theksimin e qëllimtë të produkteve ose kompanive gjatë programit.

Gjithashtu, referimi i produktit (emri i llojit) ose shërbimit në program që synon të rrisë shitjen konsiderohet reklamë.

Rastet e mundshme të reklamimit të fshehtë në programet e rregullta duhet të gjykohen nga drejtori general i RTK-së ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.

19.3 **Reklamimi për bëmirësi dhe apele të tjera sociale**

RTK-ja nuk kërkon pagesë për reklamat e organizatave humanitare dhe apelet sociale.

Organizatat dhe fondet bëmirëse si dhe institucionet sociale që nënshkruajnë marrëveshje të caktuar me RTK-në kanë të drejtë në reklama pa pagesë. Departamenti i Shërbimit të Marketingut do të programojë reklamat e organizatave humanitare në pajtim me rregullat e veçanta. Të gjitha organizatat humanitare duhet të ofrojnë dëshmi (me dokumentacion autentik) për veprimtarinë e tyre humanitare.

Gjithashtu, organizuesit jofitimprurës të ngjarjeve kulturore, shkencore, profesionale dhe sportive kanë të drejtë në reklama pa pagesë.

Reklamimi pa pagesë në programin e RTK-së është gjithashtu i mundshëm për fushatat parandaluese sociale, fushatat për ngritjen e fondeve për vendet e prekura nga fatkeqësitë dhe katastrofat natyrore.

Kur sigurohet hapësira për reklamim pa pagesë në programet e RTK-së, përparësi do t'u jepet organizatave humanitare që ngrejnë fonde për të ndihmuar njerëzit e rrezikuar ose grupet, si dhe njerëzit me të meta në Kosovë.

19.4 **Emetimi i materialit mbi marrëdhëniet me publikun**

Departamenti i Marketingut të RTK-së u ofron klientëve komerciale mundësinë e emetimit të porosisë së caktuar promovuese (marrëdhënie shoqërore). Përgjegjësia për autenticitetin e përmbajtjes bie mbi klientin.

Përderisa porositë specifike merren në konsideratë, të gjitha kontributet me qëllim të krijimit ose rritjes së reputacionit të një subjekti ekonomik ose kompanie duke prezentuar biznesin e tij, por jo me qëllim të rritjes së shitjes së produktit apo shërbimit të caktuar.

Partitë politike ose organizuesit e fushatave zgjedhore nuk kanë të drejtë të porosisin emetime të këtij lloji.

Porositë e caktuara promovuese nuk duhet të kenë tiparet e një individi në mënyrë që të ngrisin reputacionin e tyre individual apo të promovojnë çështjet politike ose religjioze.

Porositë e caktuara promovuese janë objekt i ndalesave të njëjta sikurse reklammat e tjera komerciale në programet e RTK-së.

Shkelja e kësaj dispozite gjykohet nga kryeredaktori.

19.5 Gazetarët, prezentuesit dhe redaktorët që shfaqen në reklama dhe në programe promovuese

Redaktorët, gazetarët dhe prezentuesit e RTK-së nuk janë të lejuar të paraqiten në reklama komerciale apo në programe ekonomiko-propagandistike, si dhe nuk janë të lejuar të kontribuojnë në krijimin e reklamave (në bashkëpunim me reklamuesit ose agjensionet për Marrëdhënie me Publikun).

Drejtori i programit mund të lejojë përjashtime, paraqitjen në reklama për organizata humanitare.

Këto dispozita nuk aplikohen me rastin e paraqitjes në programe promovuese të RTK-së.

19.6 Sponsorizimi në Programe

Dispozitat ligjore lejojnë sponsorizimin e programeve të RTK-së. Në rast të sponsorizimit të programit duhet të aplikohen këto kritere:

Sponsorizimi i çfarëdo programi të RTK-së nuk do të ketë ndikim në integritetin e tij profesional, autonominë ose pavarësinë financiare;

Sponsorizimi i programeve faktike, për shkak të ndjeshmërisë së çështjes, kërkon autorizim paraprak të drejtorit të programit;

Sponsorizimi i programeve të RTK-së nuk duhet të tejkalojë 50% të shpenzimeve të përgjithshme të programit, programet e sponsorizuara nga organizatat ndërkombëtare dhe humanitare ose nga buxheti i shtetit bëjnë përjashtim;

RTK-ja ka të drejtë të aplikojë në tender në ftesat për aplikim për fondet publike;

Emrat, titujt dhe falenderimi i sponsorëve duhet të publikohet në fund të programit të sponsorizuar.

Sponsorizuesit për programe individuale të RTK-së janë nën kompetencën e Departamentit të Shërbimit të Marketingut. Format që paraqesin fotografinë dhe porosinë e sponsorizuesit vendosen nga

kryeredaktori.

Negociatat për biznes me sponsorë duhet të bëhen ekskluzivisht nga përfaqësuesi i autorizuar i Departamentit të Shërbimit të Marketingut.

Sponsorizimi i programeve të prodhuara në bashkëpunim me RTK-në ose me producentë të tjerë duhet të rregullohet me kontratë përkatëse duke definuar kriteret, formën, përmbajtjen dhe vlerat me secilin sponsorizues individualisht.

20 PARAQITJA NË EMISION DHE KODI I VESHJES

Gazetarët, prezentuesit e radios dhe të televizionit dhe redaktorët duhet t'i trajtojnë mysafirët e tyre dhe të komunikojnë me publikun në mënyrë korrekte dhe me respekt.

Sido që të jetë, kjo nuk do të thotë se ata nuk janë të lejuar t'u shtrojnë të intervistuarve të tyre pyetje të hapura dhe të detajuara dhe të kërkojnë përgjigje të qarta.

Personeli që paraqitet në emisionet e RTK-së, si dhe si ekuipazhi që operon në publik, duhet të kujdesen për dukjen e tyre. Kur ata mbulojnë ngjarje formale (sesione të kongresit, ekspozita) dhe kur udhëheqin debate në studio, prezentuesit dhe gazetarët duhet të paraqiten me veshje formale. Kur mbulojnë ngjarje jashtë ndërtesës ose pika të krizave, kodi i veshjes nuk ka nevojë të respektohet në mënyrë strikte. Personeli që paraqitet në programet e tjera veshet në përshtatshmëri me përmbajtjen e programit.

21 KONFLIKTI I INTERESAVE, TË DREJTAT DHE DETYRIMET

Gazetarët, redaktorët si dhe prodhuesit e tjerë të programeve të RTK-së nuk duhet të përdorin pozitën e tyre apo të veprojnë kundër saktësisë, paanshmërisë dhe kredibilitetit të programeve të RTK-së, të rrezikojnë reputacionin e individëve ose të institucionit në tërësi apo të tradhëtojnë besimin e shikuesve dhe dëgjuesve të programeve të RTK-së me angazhimin e tyre publik dhe politik, me aktivitet e tyre në kohën e lirë, investimet e tyre private si dhe interesat financiare.

Punëtorët e rregullt të RTK-së nuk lejohen të kenë detyra, punë apo angazhime afariste jashtë RTK-së.

Keqpërdorimi i ketij (provision)? konsiderohet si shkelje flagrante e këtij Kodi. Përrjashtimi nga ky provizion mund të lejohet në raste të veçanta (vetëm për nevoja shkencore, artistike, shkollore apo sportive) vetëm nga ana e Drejtorit Gjeneral të RTK-së.

Nuk lejohet shfrytëzimi privat, i paautorizuar për përfitime financiare ose shfrytëzimi për përfitime të një pale të tretë, i emrit, të dhënave, pronësisë intelektuale, ose pajisjeve teknike apo elektronike të RTK-së.

Askujt nuk i lejohet të veprojë kundër interesave të RTK-së duke përdorur, kopjuar apo lëvizur materialin audio-video, grafik apo softuerin e krijuar, ose të zotëruar nga RTK-ja dhe të përdoret ai për levërdinë e emetuesve të tjerë, producentëve të pavarur ose grupeve të tjera të ineresuara.

21.1 Konflikti i biznesit dhe interesave tjera financiare

Nëse një punëtor, gjatë përmbushjes normale të detyrave dhe përgjegjësisë të tij ndaj RTK-së, ballafaqohet me situatën kur duhet të marrë vendim që në mënyrë direkte ose indirekte përfshin ndonjë nga anëtarët e familjes, ose ndonjë të afërm, ose kur në një çështje biznesi të RTK-së njëri nga garuesit është i afërt i punëtorit ose partner i tij, atëherë ky punëtor duhet të tërhiqet dhe të mos marrë asnjë vendim në lidhje me këtë çështje. Kjo dispozitë përfshin udhëheqësit e RTK-së, kryeredaktorët, redaktorët dhe partnerët e tjerë që kanë familjarë që punojnë në programet, prodhimet teknike dhe marketingun e RTK-së.

Punëtorët në kohën e tyre nuk duhet të punojnë për organizatat që konsiderohen si konkurrentë nga RTK-ja, duke vepruar kështu ata veprojnë kundër reputacionit dhe interesave të RTK-së. Kjo përfshin stacionet rivale të radios dhe televizionit, kompanitë televizive dhe ato kompjuterike, botuesit, agjensitë e lajmeve dhe shërbimet dokumentare.

Punëtorët e RTK-së në kohën e tyre nuk duhet t'i përdorin aftësitë e tyre profesionale për trajnimin e personelit të kompanive apo institucioneve konkurrente.

Këto dispozita nuk aplikohen në rastet kur punëtori është i involvuar në hulumtime shkencore, të udhëhequr nga univerzitetet e huaja apo vendore, kur marrin pjesë në kongreset ose seminarët ndërkombëtare, ose kur punojnë për shoqatat profesioanle jo-fitimprurëse vendore apo ndërkombëtare.

Veç kësaj, dispozitat nuk aplikohen në rastet e angazhimit artistik dhe shkencor në universitetet dhe institucionet publike, kur i ofrojnë njohuri speciale gjykatave, aktivitetve bëmirëse të cilat nuk veprojnë kundër reputacionit të RTK-së.

Aktivitete e jashtme të punëtorëve të RTK-së, nuk do të shkaktojnë shpenzime dhe nuk do të jenë kundër institucionit publik. Asnjë punëtor i RTK-së nuk është i lejuar të përdorë hapësirat e RTK-së për aktivitetet e tij të jashtme.

21.2 Paraqitja dhe pjesëmarrja në mediat rivale elektronike

Punëtorët e RTK-së mundën, nëse pajtohet paraprakisht kryeredaktori të paraqiten në role në programet e radiotelevizioneve rivale dhe mediave të tjera elektronike:

Si të intervistuar në programe faktike;

Në programet ku paraqitet puna e tij shkencore, publike ose artistike;

Si dëshmitar në programet edukative dhe dokumentare;

Si anëtar jurie ose spektator në programet argëtuese, me kusht që puna e personit të mos përmendet. **Punëtorët e RTK-së mund t'i kontribuojnë mediave të shtypura vetëm nëse kjo aprovohet paraprakisht nga kryeredaktori.**

21.3 Aktivitetet Komerciale

Me rastin e sigurimit të pajisjeve ose lidhjes së kontratës mbi programin, bashkëpunimin teknik ose të biznesit, RTK-ja nuk vepron vetëm në pajtim me rregullat ligjore por edhe duhet të ndërmer masa për mbrojtjen e reputacionit dhe interesit biznesor të RTK-së.

Punëtorët nuk duhet të kenë kurfarë lidhje familjare ose biznesore me kompaninë, organizatën apo ndonjë person jashtë RTK-së, që është i përfshirë ose i afektuar nga kontratat e prodhimeve apo shërbimeve të RTK-së.

Punëtorët e RTK-së të përfshirë në aktivitetet e tilla janë të detyruar të mbrojnë interesin biznesor dhe informatat konfidenciale, si dhe t'u ofrojnë mundësi të barabarta furnizuesve të kualifikuar dhe të pavarur.

21.4 Gazetaria Financiare

Prodhimi i programeve mbi çështjet ekonomike dhe të biznesit duhet të jetë posacërisht e ndieshme për shkak të konfliktit potencial të interesave. Punëtorët e RTK-së nuk duhet të kenë në pronësi aksionet që kalojnë 1% në kompanitë ose korporatat e tyre, dhe nuk duhet të kenë familjarë në bordin e menaxhimit të kompanisë. Menaxhmenti i RTK-së duhet të përpiqet shumë që të sigurojë që asnjë nga producentët të mos jetë i ndikuar nga interesat financiare. Është në kundërshtim me ligjin shfrytëzimi i informatave të siguruara

paraprkisht nga programi për të tregtuar.

21.5 Dhuratat, beneficionet dhe trajtimet e tjera të veçanta

Punëtorët e RTK-së duhet të refuzojnë dhuratat, beneficionet apo trajtimet tjera të veçanta të ofruara nga kompanitë, organizatat ose individët për të ndikuar në raportimin e tyre duke neglizhuar standardet profesionale të saktësisë, dhe paanshmërisë së programeve të RTK-së apo interesat tjera të institucionit publik.

Punëtorët gjithashtu duhet të refuzojnë të mirat, lirimet, shërbimet, paratë ose argëtim jashtë kufijve normalë të mikpritjes (sic janë drekat e punës ose dhuratat e vlerës modeste).

Si rregull e përgjithshme, RTK-ja financon shpenzimet e udhëtimit të punëtorëve të tij. Drejtorët e programeve mund të lejojnë përjashtime, kur udhëtimi është i financuar nga ndonjë organizatë qeveritare apo ndonjë kompani tjetër, me kusht që në asnjë mënyrë të mos ndërhyjë në integritetin profesional të emetuesit apo në pavarësinë e raportimit. Nevojat e tilla financiare duhet të përmenden në falenderimet e programit.

Punëtorët duhet të refuzojnë dhuratat që e kalojnë shumën e përafërsisht 75 Euro. Nëse refuzimi i dhuratës së tillë nuk është i mundshëm për arsye protokolare, dhurata transferohet në posedim të RTK-së.

Çmimet e fituara në festivale, gara apo ngjarje të tjera kombëtare e ndërkombëtare si rregull i takojnë autorit që i është dhënë çmimi ose ekipës së produksionit. Nëse çmimi i është dhënë RTK-së dhe është kthyer në para nga RTK-ja, duhet të informohet ekipi i produksionit dhe autorët si dhe të kompenzohen paratë e çmimit.

Autorët dhe producentët që kanë fituar çmime duhet të informojnë drejtorin gjeneral për çmimin e fituar. Rregullat mbi shpërblimet vjetore nënkuptojnë një shpërblim në të holla si mirënjohje për programin si dhe të arrituarat teknike dhe biznesore të individëve.

21.6 Aktivitetet politike, sindikaliste dhe profesionale

Punëtorët e RTK-së janë të lirë t'u bashkohen partive politike, sindikatave ose organizatave profesionale. Mospërputhja mes aktivitetit politik dhe pozitës së redaktorit ose funksioneve udhëheqëse, është e rregulluar me ligj dhe statutin e RTK-së.

Nëse aktivitetet e tyre politike, sindikaliste ose profesionale nuk përzihen me procesin e punës dhe përgjegjësitë, si dhe nëse nuk shkelin dispozitat ligjore mbi propagandën politike, kundër asnjë punëtori të RTK-së nuk duhet të merren masa ndëshkuese ose të fillohet procedurë disiplinore.

Të punësuarit në RTK që konkurojnë në zgjedhjet lokale, në zgjedhjet për Asamblenë Nacionale ose pozita të tjera zyrtare të definuara me ligj, duhet të informojnë kryeredaktorin me kohë, më së largu në kohën kur paraqesin kandidaturën.

Një punëtor konsiderohet si pjesëmarrës në fushatën zgjedhore kur ai paraqitet në listën e kandidatëve të miratuar nga partia ose si zëdhënës ose moderator në mbledhjet e partisë ose kur paraqitet në programet argëtuese ose promovuese zgjedhore.

Gjatë periudhës së zgjedhjeve kandidatët nuk lejohen të shfaqen në programet e RTK-së (me përjashtim të programeve të fushatës zgjedhore të përcaktuara me ligj dhe rregulla të fushatës zgjedhore të RTK-së); gjatë kësaj periudhe personi në fjalë nuk lejohet të ushtrojë detyrën e redaktorit, gazetarit ose prezentuesit.

Gjatë fushatës zgjedhore, kandidatët lejohen të marrin pushim pa pagesë.

Mundësia e ndryshimit të kontratës së të punësuarve, për shkak të zgjedhjes së një kandidati në një post tjetër profesional, politik ose qeveritar, përcaktohet me ligj.

Anëtarësia ose ndonjë formë tjetër e përfshirjes në ndonjë oranzatë që vepron në mënyrë sekrete nuk është e lejueshme dhe paraqet shkelje të rëndë të këtij Kodi.

22 DISPOZITAT PËRMBYLLËSE

Standardet profesionale dhe parimet e etikës gazetareske në programet e RTK-së hyjnë në fuqi pas miratimit nga ana e Bordit të Drejtorëve të RTK-së. Dokumenti do të shtypet dhe do të bëhet i mundshëm për publikun në versionin e shtypur, si dhe në faqet e Internetit të RTK-së dhe do t'u shpërndahet punëtorëve në formë të shtypur.

Të gjithë të punësuarit e RTK-së duhet ta nënshkruajnë këtë Kod dhe të garantojnë se do ta respektojnë atë.

*Vjosa Dobruna,
Kryetare e Bordit të Drejtorëve të RTK-së*

***Standardet Profesionale dhe Parimet e Etikës Gazetareske të
RTK-së janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve***